



FAQE 2



FAQE 3




FAQE 4



FAQE 5

Koha

www.koha.mk



KOHA për
enigma

FAQE 11-14

E përditshme informative Viti XI • Numri 3219 • E shtunë/e diel 11-12 nëntor 2017 15 DEN



Gazeta KOHA fiton edhe një çmim

Prishtinë, 10 nëntor - Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka ndarë për të 12 vit me radhë çmimin "Vangjush Gambeta" për gazetari hulumtuese që prekin aspektet ekonomike të sferave të ndryshme. Për gazetarinë e shkruar në Maqedoni, këtë vit çmimi iu nda gazetares së gazetës

KOHA, Evis Halili Memedaliu, me serinë e shkrimeve për politikën abuzive dhe qasjet diskriminuese ndër vite në buxhetin për kulturën shqiptare në Maqedoni. Halilit, çmimi iu dorëzua nga ambasadori i "Japan Tobacco International". Përveç çmimeve të zakonshme

për gazetari hulumtuese në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ndau edhe Çmimin e Karrierës, i cili këtë i takoi posmortum gazetarit Ramiz Kelmendi nga Prishtina. U nda gjithashtu edhe Çmimi Special për gazetarin Andrea...
Faqe 3

Zëvendëskryeministri Lika për rrugën Shkup-Bllacë

Autostradë s'ka as në mot, nis në 2019!



"Nga viti 2019 mund të fillohet me ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, edhe atë me mjete buxhetore në vlerë prej 100 milionë euro. Të shpresojmë që sa më shpejtë ta kemi gati dokumentacioni e plotë, për të cilin po punohet intensivisht dhe më në fund, ky aks rrugor të fillojë realizimin në vitin 2019", tha Lika

FAQE 3

RAJON

Familja e Xhezos mund të "shpëtojë"!



Një familje shqiptare prek zemrat e berlinezëve. Familja e Xhezo Ajazajt ndodhej para dëbimit, por reagimet bënë që senatori i Berlinit të ndryshojë mendje. Rreziku nuk ka kaluar, por të paktën rasti do të rishqyrtohet...
FAQE 16

GLOBI

Pavarësia i "kushtoi shtrenjtë" Katalonjës

FAQE 17

Skandali seksual, edhe Steven Seagal në listë

FAQE 17





Kryeparlamentari Xhaferi për punën e Parlamentit

Komisioni Evropian publikon Raportin e radhës

Rritja ekonomike sivjet 1.7 për qind

Bruksel, 10 nëntor - Komisioni Evropian në raportin e fundit ekonomik të vjeshtës parashikon se Maqedonia do të përfundojë vitin me një rritje ekonomike prej 1.7 për qind. Në raport thuhet se lëvizjet ekonomike dhe investimet në gjysmën e parë janë ulur për shkak të krizës së vazhdueshme politike, por, siç theksohet, me Qeverinë e re e cila erdhi në qershor dhe e cila paralajmëron se është e përkushtuar për zbatimin e reformave strukturore dhe fiskale dhe mbështetje në kërkesat e brendshme dhe punësime, pritet që interesi i investuesve të kthehet, ndërsa aktiviteti ekonomik të përforcohet.

Për vitin e ardhshëm, KE parashikon rritje në BPV-së të Maqedonisë prej 2.7, dhe në vitin 2019 për 3.2 për qind. Parashikohet edhe rritje e mëtejshme e punësimit dhe ulje e shkallës së papunësisë në vitin e ardhshëm në 21.4, ndërsa në 2019 në 21 për qind. KE ka parashikime optimiste për zhvillimin e ekonomisë së Maqedonisë dhe pret që rritja e BPV-së më së shumti të ndikojë në kërkesat dhe konsumin vendor. Ndikimi pozitiv do të jetë edhe rritja e pagave minimale, si dhe investimet publike.

Rritja ekonomike, sipas KE-së, mundet sërisht të ngadalësohet në rast të përkeqësimit të mëtejshëm të situatës politike, e cila, siç vlerëson, mbetet e brishtë, por megjithatë, rreziku për atë tani është shumë më i ulët se në gjysmën e parë të vitit. Komisioni Evropian gjithashtu vë në dukje se Qeveria planifikon rritje të konsiderueshme të ekonomisë në fat të mesëm dhe vendosjen e masave aktive të tregut të punës, si dhe konsolidimin të mëtejshëm fiskal.

Qëndrueshmëria fiskale mund të rrezikohet nëse Qeveria i rrit shpenzimet për subvencione dhe paga pa zbatimin të njëkohshëm të masave të konsolidimit të qëndrueshëm, vlerëson KE në raportin ekonomik të vjeshtës.

(R.K)

"Planifikojnë që Ligji i gjuhëve të jetë në Parlament që nga e hëna, në rast se nuk vjen propozimi për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Qeverisë. Debati për Ligjin planifikohet të mbarojë deri të premten", tha Kryeparlamentari Talat Xhaferi të premten gjatë një brifingu me gazetarë

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 10 nëntor - Zgjedhja e anëtarëve të Qeverisë, Ligji për përdorimin e gjuhëve, kompletimi i nënkryetarëve dhe ratifikimi i Marrëveshjes me Bullgarinë... janë prioritet kryesorë deri në fund të këtij viti të organit ligjvënës, kjo sipas asaj që tha kryeparlamentari Talat Xhaferi gjatë një brifingu me gazetarë të premten. "Planifikojnë që Ligji i gjuhëve të jetë në Parlament që nga e hëna, në rast se nuk vjen propozimi për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Qeverisë. Debati për Ligjin planifikohet të mbarojë deri të premten", tha Xhaferi. Por siç tha më tej Xhaferi, dinamika e këtij Ligji lidhet edhe me debatin dhjetëditor për Buxhetin, përveç asaj për votimin e anëtarëve të Qeverisë. Ai e la të hapur mundësinë që propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve të ekzaminohet më tej nga Qeveria, por jo duke ndryshuar dhe esencën e tij. Lidhur me nënkryetarët e Parlamentit, Xhaferi tha se shumë shpejtë do të kryhet kjo punë duke shtuar se nuk është ai që e cakton numrin e tyre, por se ai ka vepruar në bazë të, siç u shpreh, mozaikut politik që aktualisht është prezent në këtë përbërje parlamentare. "Në opinion është krijuar ideja sikur unë vendos për numrin e nënkryetarëve, gjë që nuk është e vërtetë. Unë vetëm e vendosë të propozoj numrin e tyre, por kjo nuk do të thotë se do të jenë pesë nënkryetarë. Dhe këtë e kam bërë duke u bazuar në mozaikun politik në Parlament, sepse në radhë të parë në këso rastesh vjen në shprehje vullneti i partive politike se duan të përcaktohen

Ligji për gjuhët dhe Buxheti, prioritet deri në Vitin e Ri



AGIM NUHIU DËSHMON NË PROKURORI PËR DHUNËN E 27 PRILLIT

Ish-ministri i Brendshëm, Agim Nuhiu, aktualisht zëvendësiministër në këtë dikaster, dëshmoi dje në Prokurorinë Publike në lidhje me zhvillimet e përgjakshme të 27 prillit në Parlament. Dëshminë e tij Nuhiu e ka dhënë në cilësinë e ish ministrit, duke dëshmuar për zhvillimet kryesisht brenda MPB-së dhe pengesat në komunikimet e tij me kreun e Shtabit Operativ aso kohe, ish drejtorin e Byrosë së Sigurisë Publike, Mitko Çavkov. "Kam dëshmuar mbi faktet dhe mjetet e provës të cilat tashmë edhe në opinion janë të njohura. Pra janë fakte të evidentuara dhe dëshminë tyre e kam bazuar mbi to dhe për të cilat ka pasur paraprakisht transparencë absolute", deklaroi, Agim Nuhiu, zëvendësiministër i Brendshëm.

për nënkryetarë", theksoi Xhaferi. Në lidhje me qëndrimin e VMRO-së që të mos propozojnë asnjë nga deputetët e saj për nënkryetar, kryetari i Parlamentit tha se është në të drejtën e tyre që ta bëjnë këtë, por se kush do të jetë nga opozita në këtë post - pritet të definohet kur të vijë koha. "Kushtetuta e thotë se Parlamenti mund të ketë një ose më shumë nënkryetarë, ndërsa VMRO është në të drejtën e saj që mos të propozojë. Unë nuk mund të bëj gjë në këtë drejtim. Se kush do të marrë pozitën e nënkryetarit nga partitë opozitare, mbetet të definohet më tej kur të vijë koha", theksoi Xhaferi. Duke e cekur rastin e Kumanovës, gjeësisht mundësinë që të formohet Komisioni anketues, Xhaferi tha se këtë e ka Rregullorja, "por Parlamenti nuk ka kompetenca hetuese, por vetëm të konstatojë përgjegjësinë politike nëse ka pasur në atë rast".

"Është brenda rregullave dhe procedurave parlamentare

që të formohet Komisioni anketues për rastin në fjalë, por dua t'iu kujtoj se Parlamenti nuk ka kompetenca hetuese dhe investiguese, por ai vetëm mund të konstatojë nëse ka pasur përgjegjësi politike dikush apo jo. Ju e dini se gjatë procesit gjyqësor që është në rrjedhë, pa dashur që këtu të shpjegoj kompetencat e gjyqësorit, por dua të cekë se ende nuk janë shfrytëzuar mjetet e rregullta ankimore në shkallë të tjerë dhe mjetet e jashtëzakonshme siç është kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ajo për përsëritjen e procedurës dhe këtë mund ta bëjë pala mbrojtëse apo dhe pala e dëmtuar", theksoi Xhaferi. Në pyetjen tjetër nëse si bartës i njërit ndër tre institucionet më të larta të vendit do të iniciojë Komisioni hetues edhe punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim në lidhje me skandalin e përgjimeve, ai më shumë kur ende kësaj drejtorie nuk i janë hequr kompetencat për të përgjuar pa lejen e gjykatës,

Xhaferi tha se as Kushtetuta dhe as Ligji nuk ia lejojnë që ai ta bëjë një gjë të tillë, por se kjo është në kompetencë të deputetëve. Xhaferi njoftoi për gazetarët se deri më tani janë miratuar 20 ligje të reja përfshirë dhe atë për pagën minimale.

"Në 2017 kemi miratuar 20 ligje të reja, përfshirë dhe atë për pagën minimale, prej tyre një Ligj u miratua me urgjencë, 13 në procedurë të shkurtër dhe katër ligje në procedurë të rregullt", tha Xhaferi. Por, gjatë brifingut Talat Xhaferi përmendi faktin se ai ia ka arritur me sukses që të ruajë Parlamentin nga zhargonin politik i fushatës për zgjedhjet lokale. Xhaferi njëkohësisht u zotua se Parlamenti nuk do të pushojë deri më 31 dhjetor, edhe atë - siç tha ai, nëse është nevoja edhe gjatë festave në nëntor dhe dhjetor - krejt kjo në funksion të përm-bushjes së agjendës parlamentare siç është fjala për Buxhetin dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

"Lagja e Trimave", Qeveria dakord për hetim ndërkombëtar

Shkup, 10 nëntor - Qeveria është dakord që të hapet hetim ndërkombëtar për rastin "Lagja e Trimave". Kryeministri Zoran Zaev thotë se është informuar bashkësia ndërkombëtare dhe se po kërkohen mënyra për zbatim të hetimit ndërkombëtar për rrethanat e paqartësuar

të lidhura me ngjarjet në "Lagjen e Trimave" në Kumanovë më 9 dhe 10 maj të vitit 2015. "Hap që deri tani është bërë është informimi i përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare që të mendojnë në variantet se si kjo do të realizohet. Ne nuk dëshirojmë që të ketë dilema për

punë të paqarta të cilat janë në interes për qytetarët. Ky rast edhe atë se si është në interes të qytetarëve. Besoj se do t'i gjejmë mënyrat me bashkësinë ndërkombëtare se si të formohet hetim ndërkombëtar për këtë rast", deklaroi Zaev në konferencën e sotme për shtyp

në Qeveri duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve. Gjykata Penale, siç tanimë publikoi MIA, më 2 nëntor shqiptoi tetë dënime me burg të përjetshëm dhe 26 shumëvjeçare për të akuzuarit në rastin "Lagja e Trimave", ndërsa katër u liruan nga akuzat.





Zëvendëskryeministri Lika për rrugën Shkup-Bllacë

Autostrada nis në 2019, 100 milionë euro i siguron shteti!



"Arsyeja e mos ndërtimit të këtij aksi rrugor nuk ka qenë mos interesimi i investitorëve të huaj për ta ndërtuar sipas modelit të partneritetit privato-publik, por kemi të bëjmë me prapavijë të caktuar që ky aks rrugor të mos ndërtohet", deklaroi zëvendëskryeministri Lika

ZAEVI SHUAN DILEMAT: ME PDSH-NË NUK BISEDHET PËR HYRJE NË QEVERI

Kryeministri Zoran Zaev të premten ka deklaruar se nuk zhvillohen bisedime për hyrje të PDSH-së në Qeveri. "Unë nuk kam bërë bisedime me PDSH-në për hyrje në Qeveri. Shpresoj se shpejt do t'i gjejmë zgjidhjet kadrovike për plotësimin e vendeve të zbrazëta", është shprehur Zaev duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve nëse tashmë ka biseduar me kreun e PDSH-së, Menduh Thaçi për zgjerim të koalicionit qeverisës. Mbetem, theksoi kryeministri i Maqedonisë, në përcaktimin e koalicionit aktual qeveritar për avancimin e bashkëpunimit edhe me subjekte të tjera politike dhe individë në Parlament, veçanërisht për atë që paraqet interes kombëtar, reformat dhe prioritetet kryesore të qytetarëve të Maqedonisë.



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 10 nëntor - Ndërtimi i autostradës së shumëpërfolur Shkup-Bllacë do të fillojë në vitin 2019 dhe kostoja preliminare është rreth 100 milionë euro, para të cilat do të sigurohen me buxhetin e vitit 2019. Kështu deklaroi zëvendëskryeministri i Qeverisë së Maqedonisë, Hazbi Lika, në pres konferencën e mbajtur të premten, gjatë prezantimit të Buxhetit për vitin 2018, i cili ditë më parë u miratua nga Qeveria e Maqedonisë. Deri më tani, sipas zëvendëskryeministrit Lika, ka ekzistuar vetëm projekt ideor ku janë bërë analiza të shumta se cila do të ishte alternativa më e mirë për ndërtimin e këtij aksi rrugor, siç

ishte dhënia me koncesion apo dhe ideja tjetër të ndërtohet si rrugë magjistrale, ndërsa Qeveria e re vetëm se ka filluar me përgatitjen e studimit fizibiliteti dhe kjo rrugë nuk do të jepet me koncesion apo të ndërtohet si rrugë magjistrale, por do të jetë autostradë e cila do të ndërtohet me para buxhetore.

"Nga viti 2019 mund të fillohet me ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, edhe atë me mjete buxhetore në vlerë prej 100 milionë euro. Të shpresojmë që sa më shpejtë ta kemi gati dokumentacionin e plotë, për të cilin po punohet intensivisht dhe më në fund, ky aks rrugor të fillojë realizimin në vitin 2019. Mendoj se arsyeja e mos ndër-

timit të këtij aksi rrugor, nuk ka qenë mos interesimi i investitorëve të huaj për ta ndërtuar sipas modelit të partneritetit privato-publik, por kemi të bëjmë me prapavijë të caktuar që ky aks rrugor të mos ndërtohet", deklaroi zëvendëskryeministri Lika.

Gjithashtu, zëvendëskryeministri Lika informoi se Drejtoria për Rrugët e Maqedonisë dhe Drejtoria për Mirëmbajtjen e Rrugëve të Maqedonisë, kanë përgatitur një listë të rrugëve rajonale, që do të rehabilitohen me para buxhetore sipas sistemit sllloven.

"Do të rehabilitohet rruga Mavrovë-Zhirovnice, 3 milion euro, aks rrugor shumë i rëndësishëm që do të lidhë

ZAEV NË DHJETOR NË PRISHTINË

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaev në dhjetor do të realizojë takim zyrtar në Kosovë, me ftesë të kryeministrit kosovar Ramush Haradinaj, konfirmoi për MIA-n zëdhënësi qeveritar Mile Boshnjakovski. Agjenda e vizitës, siç tha Boshnjakovski, ende nuk është caktuar.

Maqedoninë Perëndimore me rrugën e Arbrit me Shqipërinë. Edhe për rehabilitim e rrugës Strugë-Qafëthanë parashihen 3 milionë euro, për sanimin e rrugës Shkup-Bllacë 3 milionë euro, 1 milion euro për rrugën Kumanovë-Opajë dhe 5 milionë euro për rehabilitimin e rrugës Kërçovë-Makedonski Brod", deklaroi zëvendëskryeministri Lika. Ndërsa sa i përket ndërtimit të Rrugës së Arbrit dhe rrugës Tetovë-Prizren, Lika u shpreh se për këto dy rrugë ekzistojnë projekte dhe se në të ardhmen do të diskutohen në Qeveri për gjetjen e parave për ndërtimi e këtyre dy projekteve të rëndësishme, që lidhin Maqedoninë me Shqipërinë dhe Kosovën. Me buxhetin e vitit 2018, sa i përket investimeve në arsim, Lika potencoi se janë paraparë mjete buxhetore për rindërtimin e disa shkollave fillore dhe të mesme si dhe më shumë para për universitetet shqiptare. "Për universitetin "Nënë Tereza" në Shkup janë ndarë 200 milionë denarë për ndërtimin e kampusit universitar si dhe 88 milionë denarë për rroga. Për Universitetin Shtetëror të Tetovës është ndarë buxhet prej 330 milionë euro dhe 60 mijë euro për Universitetin e Evropës Juglindore", tha Lika. Gjithashtu sipas Likës 350 milionë denarë nga buxheti shkojnë për rikonstruimin e Shtëpisë së Alfabetit në Manastir dhe shënimin e 110 vjetorit të Kongresi i Manastirit do të mbahet në objektin e ri më një pamje krejtësisht ndryshe nga se jemi mësuar ta shohim deri më sot. Zëvendëskryeministri Lika, njëherit informoi se për Ministrinë e Ekologjisë, me buxhetin e vitit 2018, janë paraparë 2 milionë euro për deponitë e egra.

"Këto para kryesisht do të shkojnë për dislokimin e deponive të egra, të cilat për momentin ende po funksionojnë, sidomos në vendbanimet shqiptare", tha zëvendëskryeministri i Qeverisë së Maqedonisë, Hazbi Lika.

"Vangjush Gambeta" në duart e gazetares Evis Halili

Gazeta KOHA fiton edhe një çmim



Për gazetarinë e shkruar në Maqedoni, këtë vit çmimi iu nda gazetares së gazetës KOHA, Evis Halili Memedaliu, me serinë e shkrimeve për politikën abuzive dhe qasjet diskriminuese ndër vite në buxhetin për kulturën shqiptare në Maqedoni

Prishtinë, 10 nëntor - Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka ndarë për të 12 vit me radhë çmimin "Vangjush Gambeta" për gazetari hulumtuese që prekin aspektet ekonomike të sferave të ndryshme.

Për gazetarinë e shkruar në Maqedoni, këtë vit çmimi iu nda gazetares së gazetës KOHA, Evis Halili Memedaliu, me serinë e shkrimeve për politikën abuzive dhe qasjet diskriminuese ndër vite në buxhetin për kulturën shqiptare në Maqedoni. Halilit, çmimi iu dorëzua nga ambasadori i "Japan Tobacco International". Përveç çmimeve të zakonshme për gazetari hulumtuese në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ndau edhe Çmimin e Karrierës, i cili këtë i takoi posmortum gazetarit Ramiz Kelmendi nga Prishtina.

U nda gjithashtu edhe Çmimi Special për gazetarin Andrea Stefani. Ceremonisë i parapriu forumi "Ekonomia përballë informalitetit", ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Ramush Haradinaj. "Është duar këtë çmim. Ju falënderoj ju dhe Unionin e Gazetarëve Shqiptarë për këtë çmim dhe angazhimin e tyre për të mbështetur dhe motivuar gazetarët, mediat dhe hulumtimet, sidomos në këto momente delikate nëpër të cilat po kalojnë sidomos mediat e shkruara", tha Halili Memedaliu.

Evis Halili Memedaliu që nga themelimi i gazetës KOHA ushtron detyrën e ndihmës-kryeredaktorit, ndërsa gjatë karrierës gazetareske ka marrë edhe çmime tjera në Maqedoni.

Ndryshe, gazetarët e gazetës KOHA për të pestën herë me radhë fitojnë çmimin e parë për gazetari hulumtuese ekonomike "Vangjush Gambeta" e që ndahet nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë me seli në Tiranë.

(R.K)

NJË HAP PËRPARA PËR EMRIN E MAQEDONISË

Kryeministri Zoran Zaev deklaroi se Maqedonia duhet të jetë e gatshme për hap përpara për çështjen e emrit, duke vlerësuar se ka gjasa më të mëdha se më parë për t'u gjetur zgjidhje me Greqinë. "Me Republikën e Greqisë kemi gjasa më të mëdha se më herët për të gjetur zgjidhje. Pres që deri në fund të këtij muaji të fillojnë të lëvizin gjërat, se paku të ndërmjetësve me Nimicin. Qëndroj në dispozicion edhe për nivelin kryeministral, ministri i Punëve të Jashtme është i gatshëm, tashmë kemi biseduar me presidentin e vendit. Sa i përket kësaj çështje, Maqedonia duhet të jetë e gatshme për një hap, përpara përfundimisht për zgjidhje të kësaj çështje", tha Zaev, duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve pas prezantimit të Propozim-buxhetit për vitin 2018 në Qeveri. Shpresoj, plotësoi më tej Zaev, se opozita gjithashtu do të jetë e kyçur maksimalisht, jo për bllokada të reja, jo për shtyrje të reja, por në funksion që të bëjmë gjithçka për të gjetur zgjidhje për këtë problem të hidhur i cili është freri i RM-së dhe për proceset e saja integruese. I pyetur për idenë për riemërimin e Aeroportit të Shkupit në "Kiro Gligorov", tha se si ide fillestare i pëlqen, por se ai është vetëm njëri nga qytetarët dhe dëshiron t'i dëgjojë ata. "Fillimisht më pëlqen ideja. Dëshiroj t'i dëgjoj me kujdes qytetarët, le të zhvillohet debat, ne u qëndrojmë në dispozicion qytetarëve t'u shërbejmë në tërësi", tha Zaev.



Ankohet biznesi vendor

Të huajt na i marrin punëtorët



Një pjesë e menaxherëve të kompanive më të mëdha vendore të orientuara në eksport, kanë reaguar deri te Qeveria e re, për shkak se investitorët e huaj që fitojnë ndihmë shtetërore deri më 11 mijë euro për vend të ri pune, subvencione për trajnimin e kuadrove si dhe nuk paguajnë tatim në fitim, ua marrin punëtorët nga firmat e tyre

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 nëntor - Një pjesë e menaxherëve të kompanive më të mëdha vendore të orientuara në eksport, kanë reaguar deri te Qeveria e re, për shkak se investitorët e huaj që fitojnë ndihmë shtetërore deri më 11 mijë euro për vend të ri pune, subvencione për trajnimin e kuadrove si dhe nuk paguajnë tatim në fitim, ua marrin punëtorët nga firmat e tyre. Sipas drejtorëve të disa nga firmave më të mëdha vendore, të huajt nga njëra anë shfrytëzojnë subvencione, ndërsa nga ana tjetër marrin kuadër të gatshëm të trajnuar nga kompanitë vendore, duke vepruar në mënyrë jo të ndershme dhe jo fer. Andaj, biznesi vendor kërkon nga Qeveria e re të pengojë konkurrencën jolojale në tregun e punës, në mënyrë që kompanitë e subvencionuara do të punësojnë të papunë, që së paku 3 apo 6 muaj janë të paraqitur në Agjencinë e punësimit, duke kërkuar punë në mënyrë aktive.

Sipas analizës së revistës "Kapital", për këtë çështje kanë paralajmëruar afaristë nga më shumë sektorë, por megjithatë problemi është më i theksuar në industrinë e përpunimit të metalit, të tek-

stilit dhe atë informatike. Afaristët kanë reaguar edhe përmes odave ekonomike që të alarmojnë qeverinë se marrëveshjet për ndihmë shtetërore, me një pjesë të investitorëve të huaj i diskriminojnë firmat vendore.

"Kompanitë e huaja që punojnë në zonat thjeshtë i "sulmojnë" kompanitë vendore dhe ua marrin kuadrin e trajnuar, për të cilin nuk paguajnë asnjë kontribut. Gjithashtu, shfrytëzojnë mjetet prej 2000 deri 11 mijë euro për në vend pune, shfrytëzojnë subvencione për trajnime, ndërsa marrin kuadër të trajnuar nga kompanitë vendore dhe në këtë mënyrë veprojnë në mënyrë jo fer dhe jo të ndershme në treg", thotë për Kapital, drejtori i kompanisë Fakom, Zlatko Simonovski.

Sipas tij, në mënyrë

urgjente nevojitet që të pengohet një praktikë e tillë, sidomos te marrëveshjet e nënshkruara nga Qeveria paraprake, për shkak se në këtë mënyrë ju shkaktohet dëm direkt kompanive vendore, që i nënshtrohen kushteve jo të barabarta gjatë investimeve dhe trajnimeve të kuadrove të tyre. Simonovski shton më tej se kompanitë e huaja shfrytëzojnë subvencione nga buxheti i shtetit, të cilin e mbushin kompanitë vendore, ndërsa shfrytëzuesit e subvencioneve - kompanitë e huaja aspak nuk marrin pjesë në mbushjen e arkës shtetërore.

Ndryshe, me masat për mbështetje të eksportit, parashihet që ndërmarrjet që do të realizojnë rritje vjetore të eksportit prej së paku 5 për qind në raport me tre vitet e

fundit, do të marrin mbështetje shtesë financiare prej 10 për qind për mbulim të shpenzimeve për realizim të rritjes, por jo më shumë se 3 për qind nga shtimi i eksportit.

Secila kompani, e cila do të hapë vende të reja të punës, do të mbështetet vetëm nëse jep rrogë më të lartë për 50 për qind të pagës minimum apo mbi 18.000 denarë, dhe atë 10 për qind prej neto vlerës së rrogës do t'i kthehet investuesit. Biznesi që do të japë rrogë më të madhe, edhe më tepër do të subvencionohet dhe atë deri 16 për qind nga vlera e rrogës.

Secili që do të japë rrogë dyfish më të lartë se mesatarja e kuadrit me arsim të lartë, apo pagë mbi 45.000 denarë, do t'i kthehen 20 për qind të parave për rrogë. Investuesit e drejtpërdrejtë të huaj që do të furnizojnë mbi 10 për qind të inputeve prodhuese nga ndërmarrje vendore mbi mesataren e tre viteve të fundit, do t'u kthehet një për qind e vlerës së furnizimeve. Secila kompani që do të tregojë rritje në tre vitet e fundit dhe ulje të numrit të punësuarve, do të mund të mbështetet me 10 për qind të vlerës së investimeve që i ka bërë në vitin paraprak nëse të ardhurat rriten në krahasim me tre vitet paraprake.

85.308 TË RINJ JANË PA PUNË, 130 MIJË NUK JANË AS NË PROCESIN ARSIMOR

Shkalla e të rinjve të papunë prej 15 deri 29 vjeç në Republikën e Maqedonisë është 40.1 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2017 apo në numër absolut 85.308 persona, njofton KOHA. Rreth 130.000 të rinj prej 15-29 vjeç, nuk janë as në procesin arsimor, as në evidencën e Agjencisë për punësim të Republikës së Maqedonisë, e as në marrëdhënie pune, tha kështu dje Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska në takim in e parë të Trupit koordinues për përgatitje dhe implementim të Garancës për të rinjtë.

Alimi takoi raportuesin për Maqedoninë në PE, Ivo Vajgël

Pas zgjedhjeve, prioritet agjenda e reformave

Shkup, 10 nëntor - Koordinator i grupit parlamentar të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në Parlamentin e Maqedonisë, Ejup Alimi, të premtën pati takim me Ivo Vajgël, deputet në Parlamentin Evropian dhe raportues për Republikën e Maqedonisë në Parlamentin Evropian. Gjatë takimit u diskutua për gjendjen politike, për rrjedhën e zgjedhjeve lokale të cilat u mbajtën në vend, rrugën drejt reformave sistemore, raportet e

mira fqinjësore, si dhe anëtarësimi i vendit në strukturat euroatlantike. Siç thuhet në kumtesë, Alimi shprehu kënaqësinë e tij të madhe për rezultatet e zgjedhjeve lokale që paraqet konfirmim për përcaktimet programore të koalicionit qeveritar për reformat e thella, integrimin euroatlantik dhe barazinë në shoqëri. "Pas përfundimit të zgjedhjeve lokale Parlamentit, i kthehet Agjendës reformatore dhe në mënyrë në mënyrë më aktive do t'i përkushtohet

het masave dhe aktiviteteve që janë në drejtim të largimit të të gjitha vërejtjeve dhe pengesave për proceset euroatlantike të Republikës së Maqedonisë", tha Alimi. Vajgël, nga ana tjetër shprehu gatishmërinë për thellimin e mbështetjes së dialogut politik në vend dhe ndërtimin e konsensusit në drejtim të implementimit të Marrëveshjes së Përzihnos dhe reformat urgjente me prioritet për Republikën e Maqedonisë. Kjo mbështetje vjen drejtpërdrejtë nga Kryetari i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani dhe Komisarit për zgjerim, Johannes Han. Në këtë drejtim, Vajgël informoi për vendosjen e një formati të ri të dialogut politik të a.q. Zhan-Mone ku do të marrin pjesë përfaqësues të të gjitha partive politike me qëllim intensifikimin e proceseve reformuese në vend dhe afrimin e Republikës së Maqedonisë drejt BE dhe NATO-s. Alimi shprehu mbështetje për këtë iniciativë dhe konfirmoi se BDI

do të ketë pjesëmarrje aktive në "Zhan Mone dialogun", do t'i vendosë interesat shtetërore para interesave partiake, gjë të cilën në fakt edhe e ka konfirmuar në të kaluarën. (F.R)



do të ketë pjesëmarrje aktive në "Zhan Mone dialogun", do t'i vendosë interesat shtetërore para interesave partiake, gjë të cilën në fakt edhe e ka konfirmuar në të kaluarën. (F.R)

Saktësohen masat në pjesën e gjashtë të Planit 3-6-9

Shkup, 10 nëntor - Të gjitha masat e parapara të pjesës tre nga Planit 3-6-9 deri më tani janë realizuar, ishte konkluduar në takimin e së premtes të grupit ministror të punës, me të cilin kryesoi kryeministri Zoran Zaev. Në takim ishin saktësuar masat dhe reformat në pjesën gjashtë të Planit. Ministrat informuan se është hartuar plani i hollësishëm për aktivitetet dhe masat të cilat duhet të realizohen në periudhën dhjetor-janar, kur duhet të finalizohet edhe pjesa gjashtë nga Planit 3-6-8. Pjesa më e madhe e reformave dhe ndryshimeve ligjore janë nga fusha e gjyqësisë, reforma në shërbimet zbuluese, lufta kundër korrupsionit, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, mediat dhe reformat në fushën e administratës publike. Pas konsultimeve të bëra në takimin e djeshëm ishte konkluduar se hapat e ardhshëm nga Planit 3-6-9, në pjesën 6 dhe 0 do t'i miratojë Qeveria në seancën e ardhshme, ndërsa ndërkohë do t'i konsultojë me Komisionin Evropian dhe faktorët e tjerë relevantë. Në takimin e sotëm, kryeministri Zaev gjithashtu i angazhoi ministrat dikasterial për ligjet e parapara me Planin 3-6-9, në pjesën 6, ndërsa të cilat duhet të miratohen deri në fund të vitit, të kërkojnë dhe të marrin mendim nga përfaqësues të opozitës. Ministri në takim i kanë prezantuar edhe masat të cilat sipas Planit 3-6-9, duhet të realizohen deri në fund të marsit, vitin e ardhshëm. Takimi i djeshëm i grupit ministror të punës për ndjekjen e zbatimit të Planit 3-6-9 është pjesë e mekanizmit që e vendosi Qeveria e RM-së, përmes të cilit rregullisht, ndiqet implementimi i planit. Gjatë implementimit në mënyrë përkatëse informohen Kuvendi i RM-së, KE-ja dhe vendet anëtare të BE-së, si dhe shoqëria civile opinioni ekspert dhe opinioni më i gjerë.



Kidnapohet 52 vjeçari nga Zherovjani

Tetovë, 10 nëntor - Është kidnapuar një 52 vjeçar nga fshati Zherovjan i rrethinës së Tetovës. Sipas njoftimit të Policisë së Tetovës, të enjten, rreth orës 18, 33 vjeçari N.B nga fshati Bogovinë, ka denoncuar kidnapim të gjyshit të tij A.A nga Zherovjani, i cili më herët ka qenë i paraqitur si i humbur. Sipas policisë, në telefonin e 33 vjeçarit kanë arritur SMS porosi nga persona të panjohur se gjyshi i tij dhe vetura e tij mbahen në Strugë, dhe nuk do ta lëshojnë nëse nuk jepen 4000 euro. Por, edhe më pas, sipas kidnapuesve, gjyshi i tyre do t'u ketë borxh sërish 4000 euro. Policia ka marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit lidhur me kidnapimin e 52 vjeçarit nga fshati Zherovjan. (u.h)

Sulmohet me thikë mjeku i Toksikologjisë

Shkup, 10 nëntor - Mjeku, i cili u sulmua të enjten mbrëma në hyrje të Qendrës klinike "Nënë Tereza" është N.Z. (48) vjeçar nga f. Sllupçan, rajoni i Kumanovës. Ai është plagosur në pjesën e shpinës me mjet të mprehtë nga ana e një personi të panjohur. Policia e konfirmoi rastin dhe informon se dje rreth orës 19:50 në polici është paraqitur se në Qendrën emergjente është sjell një person i plagosur me mjet të mprehtë. Arsyja për sulmin është llogaritur personale. Për MIA-na paraprakisht rastin e konfirmoi edhe drejtori i Klinikës për Toksikologji, Niko Beqarovski, sipas të cilit, mjeku është jashtë rrezikut për jetë. Mjeku është plagosur kur po vinte në ndërrimin e natës në punë. (O.XH)

Qëndrimi i Komisionit nacional të luftës kundër trafikimit me njerëz dhe migrim ilegal është se, e drejta e kompensimit, përveç që lehtëson riintegrimin e viktimës në shoqëri, ajo ka edhe funksion parandalues (preventiv)

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 10 nëntor - Dëshmërbimin e viktimave nga trafikimi me njerëz, shteti i Maqedonisë duhet ta rregullojë me një Ligj të posaçëm, i cili në mënyrë specifike (konkrete) do ta rregullojë këtë çështje. Ose, kjo problematikë, sipas ekspertëve, duhet të zgjidhet përmes plotësimit të kornizës aktuale ligjore, për të cilin në periudhën e ardhshme - institucionet duhet të japin përgjigje se si e mendojnë ndryshimin e situatës aktuale. Ky propozim u dha në seminarin "Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit me njerëz", i cili të premtën u mbajt në Shkup, ku mes tjerash, u theksua se shteti i Maqedonisë duhet të vendos që këtë problematikë do ta zgjidhë siç bëri shteti i Kosovës me Ligj special. Përfaqësuesja e Komisionit nacional të luftës kundër trafikimit me njerëz dhe migrim ilegal të Maqedonisë, Magdalena Nestorovska, me këtë rast theksoi se dëshmërbimi i viktimave nga trafikimi me njerëz që burojnë nga procedurat penale është i rregulluar në një mënyrë të përgjithshme në Ligjin për procedurë penale. Gjatë arsyetimit të nevojës së miratimit të një Ligji të ri për viktimat nga trafikimi me njerëz, ajo tha se në normat momentale ligjore vetëm në një dispozitë e parashohin mundësinë që viktimat të gëzojnë të drejtën e dëshmërbimit. Mirëpo, sipas Nestorovskës, kompensimi si segment i rëndësishëm në rehabilitimin e viktimës nga trafikimi me njerëz ende nuk është e shfrytëzuar maksimalisht nga ana personave që kanë qenë subjekt të trafikimit. "Gjykata Penale e Shkupit, edhe pse gjatë periudhës së kaluar ka miratuar aktgjykime

Ekspertët kërkojnë Ligji special për luftë kundër trafikimit me njerëz

Të kompensohen viktimat e trafikimit



nga trafikimi me njerëz, prapë se prapë këto viktimat nga kjo tregti ilegale nuk kanë pranuar asnjë kompensim material ose jo material. Kjo situatë tregon qartë se pavarësisht cilin model të Fondit shtetëror për kompensim do ta zgjedhim, përkundër faktit se cilin pjesë të kornizës ligjore do ta bëhen ndryshime, ne posaçërisht duhet të punojmë me opinionin më të gjerë në vetëdijësimin e këtyre të drejtave. Aktiviteti tona rreth kësaj çështje duhet të përqendrohen si me viktimat nga trafikimi me njerëz,

po ashtu edhe me viktimat potenciale, të cilët duhet të informohen mjaftueshëm për mënyrën, procedurën dhe të drejtat e tyre se si të kenë qasje deri te e drejta e kompensimit", tha Nestorovska. Mes tjerash, ajo shtoi se Komisioni në fjalë, fondin kompensues për viktimat nga trafikimi me njerëz e ka paraparë në Strategjinë kombëtare për reforma në sistemin juridik. Qëndrimi i Komisionit nacional të luftës kundër trafikimit me njerëz dhe migrim ilegal të Maqedonisë është se e drejta e

kompensimit, përveç që e lehtëson riintegrimin e viktimës në shoqëri, ajo ka edhe funksion parandalues (preventiv). Komisioni nacional këtë mendim e mbështet në faktin se, përmes kompensimit - do të parandalohet mundësia që viktimat të gjendet në një pozitë të palakmueshme, gjegjësisht e njëjta për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, përsëri ekziston mundësia përsëri të bëhet viktimë e trafikimit me njerëz. Përfitimi financiar apo material, i cili do t'i ndahet viktimës, siç tha Magdalena Nestorovska, ngjallë ndjenjën se shteti kujdeset që drejtësia të dalë në shesh, gjegjësisht që të ishtë nëse kompensimi do të ishte paguar drejtpërdrejt nga personi, i cili trafikon me qenie njerëzore.

Ky projekt, i cili pritet të përfundojë nga mesi i vitit të ardhshëm, realizohet në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe me shumë institucione vendore, qëllimi të cilëve është përforsimi i kornizës efektive për qasje deri te dëshmërbimi (kompensimi) i viktimave nga trafikimi me njerëz.

MË SHUMË BUXHET PËR ROMËT

Inkluzioni i romëve është detyrë shtesë për shoqërinë e Maqedonisë dhe për këtë qëllim duhet të ketë hapësirë për avancimin e planifikimit buxhetor, deklaroi dje në Tiranë, ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. Ajo këtë e theksoi në fjalimin e konferencës rajonale për plotësimin e mungesave buxhetore në politikën për integrimin e romëve, të cilën e organizoi Ekipi aksional i projektit "Integrimi i romëve 2020", i Këshillit për bashkëpunim rajonal dhe Ministria shqiptare e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila filloi sot në Tiranë. "Përballimi me sfida të mëdha dhe përpjekje që prioritetet tona t'i ndërlikim me praktikën. Strehimi banesor është problemi më i madh në ekonominë tonë dhe buxhetin për këto qëllime duhet të rritet dyfish. Ministria në vitin 2018 do të punojë me Bankën botërore në reforma të sistemit për mbrojtje sociale, për shkak të sistemit më të mirë të mjeteve, me qëllim të zvogëlimit të varfërisë jo vetëm me pakicat, por edhe për të gjithë qytetarët tjerë", të cilët përballen me këtë problem", tha Carovska. Sipas Barometrit ballkanik, 16 afaristë udhëheqës nga Evropa Juglindore nuk do të punësonin romë, pa marrë parasysh përgatitjen e tyre profesionale, ndërsa 19 për qind nuk janë të sigurt. Pothuajse 55 për qind e punëdhënësve konsiderojnë se punësimi i romëve do të ndikonte negativisht në shitjen e mallrave dhe shërbimeve dhe në atmosferën e punës në kompani.

Me vendim të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj

290 mijë euro për familjet e të dënuarve në rastin "Kumanova"

Prishtinë, 10 nëntor - Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 219 mijë euro, për mbulimin e shpenzimeve për familjet e të dënuarve në rastin "Kumanova". Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se secila familje do t'i marrë nga 10 mijë euro. "Të ndahen nga 10 mijë euro për familjet nga shpenzimet e paparashikuara", tha Haradinaj, raportojnë mediat në Prishtinë. Haradinaj ka thënë se tashmë kanë marrë listën e familjeve. Ministri i Financave, Bedri Hamza, ndërkohë ka kërkuar që të dihet numrat e xhirlogarive të familje. Ndryshe, ditë më

parë, Gjykata Penale e Shkupit dënoi me 746 vjet burg 33 pjesëtarët e grupit të Kumanovës. Shtatë dënime me burg të përjetshëm, 13 persona u dënuan me 40 vjet burg, 6 persona me nga 20 vjet, njëri nga të akuzuarit u dënuar me 18 vjet, dy me nga 14 vjet dhe dy pjesëtarë tjerë me nga 13 vjet. Në mungesë të dëshmitëve, katër persona u liruan nga të gjitha akuzat. Me burg të përjetshëm u dënuan: Andi Krasniqi-Malisheva, Demë Shehu, Fadil Fejzullahu, Nasuf Zeqiri, Valdet Zekaj, Beg Bajra dhe Fejzulla Rushitovski. Personat e dënuar me burg të përjetshëm

janë Andi Krasniqi - Malisheva, Demë Shehu, Fadil Fejzullahu, Nasuf Zeqiri, Valdet Zekaj, Beg Bajra dhe Fejzulla Rushitovski. Sami Ukshini i njohur si komandant Sokoli u dënuar me 40 vjet burg. Po me aq vite burg u dënuar edhe Esat Kafegjollli, Adrian Bujari, Shefqet Hallaqi, Enver Hoxha-Kllajn, Bajram Elshani, Nexhmedin Lika, Rufki Dogani, Betim Kabashi, Lirim Krasniqi, Sevdail Miftari, Fatmir Reçica dhe Genti Sefaj Personat e dënuar me nga 40 vjet burg janë Sami Ukshini - Sokoli, Esat Kafegjollli, Adrian Bujari, Shefqet Hallaqi, Enver Hoxha-Kllajn, Bajram



Elshani, Nexhmedin Lika, Rufki Dogani, Betim Kabashi, Lirim Krasniqi, Sevdail Miftari, Fatmir Reçica dhe Genti Sefaj. Personat e dënuar me nga 20 vjet burg janë Fadil

Elshani, Lirim Demiri, Harjush Abdia, Lendrit Rrustemaj, Mirsad Qerimi dhe Kenan Iseini. Me 18 vjet burg u dënuar Ragmi Latifi, ndërsa me nga 14 vjet burg u dënuar Irfan

Lutfiu dhe Sadudin Abdullahu. Me nga 13 vjet u dënuar Arsim Bajrami dhe Elham Arifi. Ndërsa me nga 12 vjet u dënuar Musa Pajaziti dhe Ebib Alimi.



Hiqen paraqitjet vjetore tatimore

Shkup, 10 nëntor - Qytetarët nuk do të kenë detyrim që të parashtrorin deri te Drejtoria për të Ardhura Publike, paraqitje vjetore tatimore për të ardhurat e realizuara plotësuese. Kjo është parashikuar me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tatim personal të të ardhurave, të cilat u shqyrtuan në seancën e fundit të Qeverisë së Maqedonisë. Sipas propozim-ligjit, në vend të qytetarëve që këtë do ta bëjë DAP, ndërsa qytetarët do të duhet vetëm t'i konfirmojnë ose korrigjojnë informacionet e paraqitjeve. Paraqitjet vjetore tatimore, qytetarët i parashtrorin për të ardhura të realizuara plotësuese në vitin që kalon, ndërsa paraqitja parashtrorhet më së voni deri më 15 mars të vitit në vijim. Detyrim për parashtrim të paraqitjes vjetore tatimore kishin qytetarët, të cilët krahas rrogës ose pensionit, kanë realizuar të ardhura si për shembull në bazë të blerjes, kontratave autoriale... Këtë vit, për të ardhura të realizuara në vitin 2016 janë parashtruar rreth 400.000 paraqitje vjetore tatimore.

Rritet numri i turistëve

Shkup, 10 nëntor - Maqedonia në shtator të këtij viti ka pasur 104.120 turistë, me 242.719 bujtje, që në krahasim me shtatorin e vitit të kaluar, paraqet një rritje prej 23.9 për qind ose për 23.1 për qind, publikoi sot Enti Shtetëror i Statistikës. Në shtator të këtij viti në krahasim me shtatorin e vitit të kaluar ka pasur 29.1 për qind më shumë turistë të huaj, me 22.8 për qind më shumë bujtje, ndërsa për 10 për qind më shumë turistë vendas, të cilët shënojnë më shumë bujtje për 23.8 për qind. Në periudhën janar-shtator, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri i turistëve është rritur për 16.7 për qind, me ç'rast te turistët vendas ka rritje për 6.9 për qind, ndërsa tek turistët e huaj për 23.7 për qind. Në nëntë muajt e parë të vitit kishte 12.4 për qind më shumë bujtje, me rritje prej 5.3 për qind te turistët vendas dhe 22.6 për qind te turistët e huaj.

Turizëm bashkë me Malin e Zi

Shkup, 10 nëntor - "Nxitja e bashkëpunimit në turizëm përmes prezantimit të potencialëve të përgjithshme ekonomike në Tivat" ka qenë tema e forumit të djeshëm të biznesit që e organizon Ambasada e Malit të Zi në Maqedoni në bashkëpunim me Shoqatën e hotelierisë dhe turizmit pranë Odës ekonomike të Maqedonisë. Në forum është bërë fjalë edhe për vendosje të linjës ajrore Shkup-Podgoricë-Sarajevë. "Qëllimi i forumit është në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e turizmit mes Maqedonisë dhe Malit të Zi, i cili zbatohet tetë vite, të nxitet para se gjithash bashkëpunimi në turizëm, por edhe në sektorin e ushqimit, i cili direkt apo indirekt është i ndërlidhur me zhvillimin e turizmit dhe hotelierisë. Aktiviteti i im duhet të mundësojë lëvizje më të madhe të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve në dy drejtimet, që si qëllim përfundimtar do të kontribuojë për vëllimin e rritur të bashkëpunimit ekonomik mes Malit të Zi dhe Republikës së Maqedonisë, rritjen e numrit të turistëve në dy drejtimet dhe zhvillim i llojeve të reja të prodhimeve turistike", informojnë nga Oda. Në forumin e biznesit kanë marrë pjesë përfaqësues eminent nga fusha e hotelierisë dhe turizmit nga Maqedonia dhe Mali i Zi.

Organizatrat për mbrojtjen e ambientit përshëndesin aktivitetet

Organizatrat për mbrojtjen e ambientit jetësorë përshëndesin masat që po ndër marrin autoritetet lokale e qendrore të Maqedonisë për të ulur shkallën e lartë të ndotjes së ajrit. Shkupi dhe Tetova janë qytetet me ajrin më të ndotur në Evropë, kurse grimcat PM10 shënojnë rritje për pesë herë mbi normën e lejuar

Shkup, 10 nëntor - Shkupi, Tetova dhe Velesi për disa ditë me radhë kanë shënuar indeksin më të lartë të ndotjes së ajrit. Ministri i Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Sadulla Duraku paralajmëroi kontrolle të forcuara të kapaciteteve industriale, subvencionimin e filtrave, si dhe inkurajimin e përdorimit të automjeteve elektrike. Ndërkohë që janë paralajmëruar ndryshime ligjore, sipas të cilave, për automjetet në qarkullim do të nevojitet të sigurohen etiketa ekologjike para kontrollit teknik. Ndërkaq ato që e ndotin ajrin, kërkohet të largohen nga komunikacioni. Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov propozoi zvogëlimin e çmimit të ngrohjes qendrore, rritjen e çmimeve për parking në kryeqendër si dhe uljen e çmimeve për transportin publik. Nga shoqata "Eko Guerila" thonë se këto masa duhet të gjejnë zbatim të menjëherëshëm duke sanksionuar shkelësit e ligjit. "Shpresojmë se këto masa nuk do të mbeten vetëm në fazën e rekomandimeve ose të jenë masa vetëm në letër ashtu siç ka ndodhur deri para pak kohësh. Shpresojmë që Qeveria e re do të ketë një qasje më serioze sa i përket këtij problemi, që ka të bëjë



Masa të rrepta kundër ndotjes së ajrit

me shkallën e lartë të ndotjes së ajrit, dhe këto masa do të jetësohen tërësisht për të ulur sado pak ndotjen e ajrit në Maqedoni", thotë për Radion Evropë e Lirë, Arianit Xhaferi nga organizata joqeveritare "Eko Guerila" në Tetovë. Rezultatet e një hulumtimi të UNDP-së kanë nxjerr në pah se amvisëritë përmes ngrohjes me dru dhe materialeve të ndryshme ndotëse, përbëjnë një të tretën e ndotësve kryesorë të ajrit. Në këtë drejtim, Ana Colloviq-Leshkoska nga organizata joqeveritare "Eko Svest" (Eko Vetëdija) thotë se kualiteti i ajrit në qytetin e Shkupit do të mund të përmirësohet dukshëm nëse autoritetet përkatëse arrijnë të zgjidhin problemin me ngrohjen e amvisërive. "Si përfundim, pjesa më e madhe e masave që ne i propozuam gjatë dimrit të kaluar dhe gjatë muajve të

verës, autoritetet përkatëse i kanë marrë parasysh, veçanërisht masat që kanë të bëjnë me kontrollin teknik të automjeteve dhe vendosjes së tiktave varësisht shkallës me të cilën ato ndotin ajrin gjatë qarkullimit", thotë Ana Colloviq-Leshkoska. Organizatat joqeveritare thonë se në ndotjen e ajrit në masë të madhe kanë ndikuar ndërtime të fundit në qytetin e Shkupit duke bllokuar qarkullimin e ajrit. Shkupi dhe Tetova janë qytetet me ajrin më të ndotur në Evropë, kurse grimcat PM10 shënojnë rritje për pesë herë mbi normën e lejuar. Masat e propozuara nga autoritetet përkatëse të Qeverisë përkatëse të zbatohen menjëherë pas miratimit të buxhetit për vitin 2018, duke paralajmëruar dhe më shumë masa të tjera sa i përket uljes së shkallës së ndotjes së ajrit. (REL)

ARIANIT XHAFERI

“Shpresojmë se këto masa nuk do të mbeten vetëm në fazën e rekomandimeve ose të jenë masa vetëm në letër ashtu siç ka ndodhur deri para pak kohësh. Shpresojmë që Qeveria e re do të ketë një qasje më serioze sa i përket këtij problemi, që ka të bëjë me shkallën e lartë të ndotjes së ajrit, dhe këto masa do të jetësohen tërësisht për të ulur sado pak ndotjen e ajrit në Maqedoni

Klubi diplomatik me kërkesë drejtuar Qeverisë

Aeroporti të riemërohet në "Kiro Gligorov"

Shkup, 10 nëntor - Klubi diplomatik - Shkup jep mbështetje që Aeroporti ndërkombëtar i Shkupit ta mbajë emrin e ish-presidentit të Maqedonisë, Kiro Gligorov. "Thesojmë se nga Aeroporti i Shkupit filluan dhe nga ai përfunduan 'ekspeditat' e presidentit Gligorov në botë, udhëtimet e tij, dedikuar paqes dhe miqësisë dhe për etablimin ndërkombëtar të shtetit të Maqedonisë. Në mungesë të tij këtu, për herë të parë, në praktikë janë vendosur manifestimet protokollare siç janë valëvitja e flamurit shtetëror, intonimi i himnit, stacionimi i gardës së nderit, me të cilët para botës Republika e Maqedonisë u paraqit si shtet i pavarur. Nga ky aeroport fluturuan edhe aeroplanët e parë me simbolet shtetërore të Maqedonisë", theksohet në kumtesën e Këshillit drejtues të Klubit diplo-



matik. Klubi shton se emërimi i aeroportit të Shkupit me emrin e presidentit Gligorov, në mënyrë më dinjitoze do të materializohet vlerësimi për rolin e tij të madh në procesin e krijimit të Maqedonisë si shtet bashkëkohor - përkujtes i përhershëm në memorien kolektive të qytetarëve të tij. Këshilli drejtues i Klubit diplomatik gjithashtu e mbështet edhe iniciativën e

Unionit Filatelist të Maqedonisë për dhënie të pullës postare me rastin e përvjetorit të 100-të të lindjes së presidentit Kiro Gligorov. Këtë vit shënohet jubileu, njëqind vjet nga lindja e presidentit të parë të Republikës së Maqedonisë, Kiro Gligorov dhe Klubi diplomatik thekson se në vazhdimësi shumë herë dhe në mënyra të ndryshme e ka shprehur respektin e vet

për veprën e tij, ndërsa në maj të këtij viti në ASHAM ishte organizator edhe i konferencës shkencore "Roli i Kiro Gligorovit në etablimin ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë". Në përgatitje është publikimi me fjalim në këtë konferencë dhe me përqendrim të personaliteteve të shquara vendorë dhe të huaj për veprën e Kiro Gligorovit.



Roaming më të lirë me Bullgarinë

Sofje, 10 nëntor - Realisht është që vitin e ardhshëm gjatë kryesimit të Bullgarisë me Këshillin e Bashkimit Evropian të zvogëlohet çmimi i roamingut me Maqedoninë dhe me shtetet tjera nga Ballkani Perëndimor, vlerësoi ministri i Transportit, Teknologjive Informatike dhe Komunikime-

ve, Ivajlo Moskovski. Siç sqaroi, Bullgaria ka përgatitur memorandum me të gjitha shtetet nga Ballkani Perëndimor për zvogëlimin e çmimeve në roaming. Ato janë memorandume në nivel shtetëror, e jo evropian, e të cilat do të japin "dritë të gjelbër" që operatorët t'i zvogëlojnë çmimet për bisedë,

porosi dhe internet në roaming, transmeton DPA. Moskovski në fillim të muajit deklaroi se pret që deri nga fundi i vitit operatorët të nënshkruajnë marrëveshje, duke i cilësuar si të tmerrshme çmimet e tanishme prej 6-7 levë për një minutë me Maqedoninë, Bosnjë e Hercegovinë

dose Serbinë. Paralajmërimet nga Sofja për zvogëlimin e çmimeve do të jetë iniciativa e dytë konkrete në atë drejtim për rajonin. Tre vite me radhë në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë janë zvogëluar çmimet në roaming mes Maqedonisë, Serbisë, Bosnjë e Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Publikohet konkurs i MASH-it

Studenti, i cili ka konkurruar për dy ose më shumë grupe të bursave dhe i ka plotësuar kushtet për marrje, i ndahet bursë sipas prioritetit të cilin e ka bërë në listën evidentuese

Sivjet 2890 bursa për studentë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 10 nëntor - Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin akademik 2017/2018 do të ndajë gjithsej 2890 bursa për studentët e rregullt të regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë i universiteteve publike dhe private dhe institucionet për arsim të lartë. Sipas Konkursit, të cilin MASH e publikoi dje, do të ndahen 1500 bursa për studentë nga kategoritë sociale, si dhe 630 bursa (590 bursa për studentët e regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë në universitetet publike dhe institucionet e arsimit të lartë dhe 40 bursa për studentë të regjistruar në studimet universitare, nga cikli i parë në universitetet private dhe institucionet për arsim të lartë), për studentët të cilët kanë arritur sukses jashtëzakonisht të lartë në mësim. Për studentët e regjistruar në fakultetet teknike dhe shkencat mjekësore të cilët kanë arritur sukses mesatar nga viti i parë studimor nga regjistrimi vijues prej të paktën 8.50, ndërsa për studentët e fakulteteve nga artet shoqërore dhe në fakultetet nga artet të kenë të arritur të paktën 9.00 sukses mesatar nga viti i parë deri në vitin vijues i regjistruar studimor. Për studentët e regjistruar në programin studimor për informatikë do të ndahen 125 bursa, nga të cilët 105 bursa për studentë të regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë në universitetet publike dhe në institucionet e arsimit të lartë dhe 20 bursa për studentë të



regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë në universitetet private dhe institucionet për arsim të lartë. Pesëqind e pesëdhjetë bursa janë siguruar për studentët të regjistruar në programet studentore nga fushat e shkencave matematikonoatyrrore, teknike-teknologjike, shkencat bioteknike ose mjekësore dhe të cilët kanë arritur sukses mesatar nga viti i parë deri në vitin vijues të regjistruar studimor me sukses të arritur 7.00 mesatar, ndërsa 105 bursa do të ndahen për studentë, të regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë në universitetet private dhe institucionet për arsim të lartë, të cilët kanë arritur sukses mesatar nga viti studimor deri te viti vijues i regjistruar studimor të paktën 7:00 sukses mesatar, ndërsa janë regjistruar në programet studimore për kimi, fizikë dhe matematikë. Vlera e bursës për grupin e parë - bur-

sa për studentë nga kategoritë sociale arrin 3300 denarë, në muaj, për nëntë muaj gjatë vitit studimor. Vlera e bursës për grupin e dytë - bursa për studentë të cilët kanë arritur sukses jashtëzakonisht të lartë në mësim dhe të cilët kanë arritur sukses mesatar nga viti i parë deri në viti vijues të regjistruar studimor në fakultetet teknike dhe shkencat mjekësore të paktën 8.50, ndërsa për studentët e fakulteteve nga shkencat shoqërore dhe të fakulteteve nga shkencat e artit të kenë të arritur të paktën 9.00 suksesin mesatar arrin 4400 denarë në muaj, për nëntë muaj gjatë vitit studimor. Vlera e bursës për grupin e dytë - bursa për studentë të cilët kanë arritur sukses jashtëzakonisht të lartë në mësim prej të paktën 9.00 në programet studentore për informatikë arrin 6050 denarë në muaj për nëntë muaj gjatë vitit studimor. Vlera e bursës

për grupin e tretë - bursa për studentë të regjistruar në programet studentore nga fushat e shkencës matematikonoatyrrore, teknike-teknologjike, bioteknike dhe shkencat mjekësore arrin 3.300 denarë në muaj, për nëntë muaj gjatë vitit studimor. Vlera e bursës për grupin e tretë - bursa për studentë të regjistruar në programin studentor për kimi, fizikë dhe matematikë arrin 18.000 denarë në muaj, për nëntë muaj gjatë vitit studimor. Studenti, i cili ka konkurruar për dy ose më shumë grupe të bursave dhe i ka plotësuar kushtet për marrje, i ndahet bursë sipas prioritetit të cilin e ka bërë në listën evidentuese. Studentët të cilët paraqiten në konkurs duhet të plotësojnë fletëparaqitje elektronike të vendosur në internet portalin <http://konkursi.mon.gov.mk>, duke filluar prej dje (10 nëntor) përfundimisht me 20 nëntorin e vitit 2017.

Shkup, për një javë 81 aksidente

Shkup, 10 nëntor - Gjatë javës së kaluar në Shkup kanë ndodhur 81 aksidente trafiku. Prej tyre në gjashtë aksidente ka pasur persona të lënduar më rëndë, ndërsa në një aksident një person e ka humbur jetën. Nga numri i përgjithshëm në 27 aksidente janë lënduar 44 persona, ndërsa në 47 është shkaktuar dëm material. Nga SPB Shkup gjatë javës së kaluar pas kontrolleve të zbatuara ndaj pjesëtarëve në trafik, janë zbuluar dhe sanksionuar një numër i madh të shkeljeve, me ç'rast janë sanksionuar 304 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 24 shoferë kanë drejtuar automjetin në ndikim të alkoolit, 83 kanë drejtuar automjetin para se ta marrin të drejtën për drejtim të automjetit, nëntë shoferë kanë kaluar në dritë, si dhe 353 shoferë janë parkuar në mënyrë të parregullt.

Fundjava me shi dhe borë

Shkup, 10 nëntor - Të reshura të shiut më të rrëmbyeshëm edhe deri në 25 litra për metër katror, ndërsa në zonat malore do të bjerë borë, paralajmëroi për fundjavën e ardhshme Drejtoria për Punë Hidrometeorologjike. Të reshurat e shiut do të jetë më të theksuara sot (e shtunë) pasdite në pjesën perëndimore dhe jugore të Maqedonisë. Borë, ndërkaq do të bjerë në zonat më të larta malore në Maqedoninë veriperëndimore. Të dielën dhe të hënën, reshjet do të jenë më të lokalizuara dhe do të fryjë erë mesatare nga drejtimi jugor. Të dielën do të ketë kushte për mjegull në mëngjes dhe në disa lugina. Më shumë reshje pritet përsëri të martën dhe të mërkurën, ndërsa nga e mërkura edhe rënie të temperaturave që do të shkaktojë reshje në zonat malore dhe në disa vende më të larta reshjet e shiut do të kalojnë në borë.

Nga e mërkura mos i harroni pajisjet dimërore

Shkup, 10 nëntor - Nga e mërkura (15 nëntor) fillon të vlejë obligimi i detyruar për mbajtje të pajisjes dimërore në automjete që do të zgjasë deri më 15 mars. Shoferët, të cilët nuk do ta respektojnë këtë obligim, do të dënohen me 45 euro në kundërvlerë të denarit apo me 25 pikë negative. Nën pajisje dimërore të automjeteve motorizuese me masë të lejuar, e cila nuk tejkalon 3.500 kg nënkuptohen pneumatikët dimëror të të gjitha rrotave me thellësi minimale të vijave prej 4

mm., apo goma të verës në të gjitha rrotat me thellësi prej së paku 4 mm, nëse automjeti në pajisje ka edhe zinxhirë për borë. Automjetet motorizuese me rrota 4x4 nevojiten të kenë goma të dimrit në të gjitha rrotat me thellësi minimale prej 6 mm apo pneumatikë me profil veror në të gjitha rrotat me thellësi të vijave prej së paku 4 mm, nëse në automjet ka zinxhirë për borë. Për automjetet të cilat janë më të rënda se 3.500 kg si pajisje dimërore konsiderohen gomat e

dimrit me thellësi minimale të vijave prej 6 mm apo goma të verës në të gjitha rrotat me thellësi të vijave prej minimum 4 mm, nëse në automjet ka zinxhirë për borë. Autobusët dhe automjetet transportuese, të cilat për shkaqe teknike nuk mund të vendosin zinxhirë për borë, duhet të kenë pneumatikë dimëror dhe lopatë. Sipas rregullores goma të dimrit janë ato pneumatikë të cilët në pjesën e vet anësore kanë shenjën: "MS", "M+S", "M&S" dhe shenjët e fjollës së borës në malin



e stilizuar me tre maje. Gjithashtu, sipas Rregullores, në qarkullimin rru-

gor nuk vendosen pneumatikë me gozhda. Detyrimi për pajisjen e domo-

sdoshme dimërore zgjat deri më 15 mars të vitit të ardhshëm.



Problematike në këtë drejtim janë shumë rrugë në qytetin e Tetovës, sidomos rruga e Spitalit nga qendra, rruga afër tregut të gjelbër dhe bulevardi i lindenit

Vozitësit thonë se policia nuk tregohet e ashpër me vozitësit, të cilët nuk respektojnë rregullat bazë në komunikacion dhe parkohen në ato vende ku pengojnë zhvillimin normal të komunikacionit. Nga policia thonë se këto rrugë do të jenë prioritet në të ardhmen, ngase krijohet shumë kaos dhe vozitësit e sidomos këmbësorët, hasin në shumë pengesa nga parkimi vend e pa vend i automjeteve

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 10 nëntor - Gjatë 10 muajve të kaluar të këtij viti, nga ana e Policisë së Tetovës, përmes shërbimit të merimangës, janë larguar nga rrugët e Tetovës 1500 vetura që kanë qenë gabimisht të parkuara. Të njëjtat kanë penguar zhvillimin normal të komunikacionit, kurse kjo dukuri më e theksuar ka qenë dhe vijon të jetë prezent në pjesën qendrore apo në bulevardet kryesore.

“Në këtë aktivitet, tashmë me dy automjete të merimangës, me intensitet të njëjtë do të vazhdohet edhe në periudhën që vjen, ndërsa cak do të jenë veturat që parkohen në trotuare, në vijat e shënuara për këmbësorë, veturat e parkuara në udhëkryqe”, thotë Marjan Josifoski, zëdhënës i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë.

Problematike në këtë drejtim janë shumë rrugë në qytetin e Tetovës, sidomos rruga e Spitalit nga qendra, rruga afër tregut të gjelbër dhe bulevardi i lindenit. Nga policia thonë se këto rrugë do të jenë prioritet në të ardhmen, ngase krijohet shumë kaos dhe vozitësit, por sidomos edhe këmbësorët, hasin në shumë pengesa nga parkimi vend e pa vend i automjeteve.

Parkohen edhe në udhëkryqe

Mbi 1500 vetura u larguan me merimangë



“Një ndër prioritetet do të jenë rrugët afër objekteve shkollore, pranë Spitalit Klinik të Tetovës dhe institucioneve tjera shtetërore, që ndodhen pranë tregut të gjelbër ku krijohet radhë të mëdha për shkak të parkimit jo adekuat të automjeteve”, theksoi Josifoski.

Vozitësit, nga ana tjetër, thonë se policia nuk tregohet e ashpër me këta vozitës, të cilët nuk respektojnë rregullat bazë në komunikacion dhe parkohen në ato vende ku pengojnë zhvillimin normal të komunikacionit.

“Policia duhet që të largojë menjëherë veturat të cilët parkohen në rreth-rrotullime, në udhëkryqe, pranë lokaleve. Shpesh herë këto vetura nuk largohen ngase vozitësit njohin ndonjë polic dhe u lejohet të parkohen në ato vende. Kurse, në anën tjetër dënohen ata qytetarë që nuk kanë asnjë të

njuhur. Kjo është e padrejtë, por edhe krijon shumë probleme në rrugët e Tetovës”, thotë Bekimi, një vozitës.

Edhe pse kjo situatë vazhdon vite me radhë të shqetësoshëm të cilët parkojnë veturat e tyre në vende të ndaluara për parkim. Kësisoj, në pjesët qendrore të qytetit qarkullojnë me mijëra vetura brenda ditës duke e paralizuar këtë pjesë dhe duke e bërë të pakalueshme. Ekspertët e këtij lëmi janë të mendimit se shtimi i automjeteve dhe mungesa e parkingjeve janë arsyt kryesor të kaosit në pjesën qendrore. Mungesa e investimeve serioze në depërtimin e tre bulevardëve kryesorë të qytetit, mbi të cilët bazohet i tërë rrjeti kryesor i komunikacionit rrugor është shkak kryesor i këtij kaosi, kurse mungesa e transportit të organizuar publik të automjeteve edhe më tepër e rëndojnë këtë çështje.

“Me këtë rast nuk do të tolerohet asnjë vozitës që ka bërë kundërvajtje dhe do të përballlet me dënim prej 45 deri në 180 euro. Kjo do të ndodh për arsye sepse frekuentimi më i madh është në pjesën qendrore të Tetovës dhe duhet që të ketë më shumë rend gjatë parkimit, sepse veturat e parkuara gabimisht, në masë të madhe e rëndojnë qarkullimin normal të veturave dhe këmbësorëve. Nga policia e Tetovës kanë apeluar që qytetarët të jenë sa më shumë të kujdesshëm dhe të mos parkohen në vende të ndaluara pasi që

në këtë mënyrë i kontribuojnë kaosit në ndërkohë dënimet do të jenë të mëdha. Por, edhe përkaj këtyre aktiviteteve gjithnjë në pjesët qendrore vërehen vozitës të pandërgjegjshëm të cilët parkojnë veturat e tyre në vende të ndaluara për parkim. Kësisoj, në pjesët qendrore të qytetit qarkullojnë me mijëra vetura brenda ditës duke e paralizuar këtë pjesë dhe duke e bërë të pakalueshme. Ekspertët e këtij lëmi janë të mendimit se shtimi i automjeteve dhe mungesa e parkingjeve janë arsyt kryesor të kaosit në pjesën qendrore. Mungesa e investimeve serioze në depërtimin e tre bulevardëve kryesorë të qytetit, mbi të cilët bazohet i tërë rrjeti kryesor i komunikacionit rrugor është shkak kryesor i këtij kaosi, kurse mungesa e transportit të organizuar publik të automjeteve edhe më tepër e rëndojnë këtë çështje.

Edicioni i parë të Festivalit "Othello" Të parët në skenë aktorët durrsakë

Gostivar, 10 nëntor - Në Qendrën për kulturë në Gostivar, të enjten mbrëma, u hap edicioni i parë i Festivalit të Teatrot "Othello", në organizim të Shoqatave për Kulturë "Othello" dhe "Fishta" nga Gostivari.

Festivalin e shpalli të hapur kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Taravari, i cili para artdashësve gostivaras tha se politika duhet të heqë dorë nga kultura dhe ta lë atë që të frymojë lirshëm, thuhet në kumtesë.

Ai shtoi se i përgëzon të gjithë ata që kontribuuan që ky festival të jetë shohet, e sidomos drejtorin e festivalit, Argjent Hasani, me të cilin e ndan mendimin se përfundimisht politika duhet të shkëputet nga kultura dhe arti të frymojë lirshëm në të ardhmen në këto troje.

"Ju ftoj që njëjloj si sonete, edhe në netët tjera ta mbushim përplot sallën e Qendrës për kulturë. Të kënaqemi vetë dhe ta shpërblejmë me duartrokitje mundin e aktorëve", theksoi mes tjerash Taravari.

Siç njofton MIA, të pranishmëve iu drejtua edhe drejtori i Festivalit, aktori nga Gostivari, Argjent Hasani, i cili me këtë rast falënderoi të gjithë ata të cilët kontribuuan dhe ndihmuan që ky Gostivari të jetë nikoqir i një festivali kaq të rëndësishëm.

"Nuk ka fund sukcesi, nuk ka fund ideja, prandaj jemi përpjekur në maksimum që qytetarët tanë të kenë se çka të shohin, qytetarët të dalin nga ajo kafeja e përditshme dhe të vijnë të mbushin shpirtin me art. Uroj që festivali të bëhet tradicional dhe të mos ndalet këtu. Jemi të hapur për të gjithë artistët kudo që janë me të vetmin qëllim që spektatorit t'i sjellim më të mirën nga ne. Faleminderit publikut që mund ta mbajë të gjallë këtë festival", tha Hasani.

Në natën e parë të Festivalit u shfaq komedia "Një jetë me ty" e teatrit "Aleksandër Moisiu", nga Durresë, me autor dhe regjisor Erion Kame. Ndryshe, Festivali ka karakter garues, ndërsa juria profesionale përbëhet nga Sulejman Rushiti, Ismet Ramadani dhe Muzafer Etemi.



Fillon pastrimi i rrugës Saraj-Bojanë

Shkup, 10 nëntor - Komuna e Sarajit ka ndërmarr një nismë për pastrimin e rrugës kryesore dhe mirëmbajtje, duke filluar nga Saraji deri në Bojanë.

Punëtorët kanë filluar në pastrimin e rrugës, duke hequr pengesat anësore - pastrimi i therrave dhe kaçubave që pengojnë qarkullimin në komunikacion.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve kryesore, nga Komuna e Sarajit, do të bëhet në çdoherë. Tani ka filluar të pas-

trohet rruga 402 që njihet si rruga Saraj-Bojanë, me mbarimin e kësaj do të fillohet rruga tjetër 403, që njihet si rruga kryesore Kondovë-Radushë dhe Kondovë-Rashçe. Punime dhe aktivitete të tilla, do të jenë më të shpeshta nga Komuna e Sarajit, në sezonin pranveror. Këto nisma ndërmerren, si nevojë e komunikacionit që zhvillohet në këto dy rrugë që janë shumë frekuentuese nga banorët e Sarajit.

Taravari premtan bashkëpunim dhe transparencë

Gazetarët u informuan nga kryetari se tashmë në postin ushtrues detyre në Ndërmarrjen publike "Komunalec" është caktuar Isak Lazami

Gostivar, 10 nëntor - Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, organizoi një takim joformal me gazetarët lokalë. Në takimin i cili kaloi në një atmosferë miqësore, kryetari i njoftoi ata, se prej javës së ardhshme do të fillojë të funksionojë me kapacitet të plotë shërbimi për informim dhe se mangësitë eventuale në ditët e para të mandatit të

tij do të tejkalohen.

"Ju siguroj se së shpejti do të kemi një ekip të konsoliduar të PR-it dhe se në kohë reale do të jeni të informuar me të gjitha ngjarjet që janë me interes për ju si gazetarë për të informuar publikun e gjerë. Ekipi i PR-it do të jetë i hapur për bashkëpunim, ndërsa do të kenë qasje të shpejtë edhe për çdo informatë me karakter publik", theksoi Taravari dhe shtoi se takimet e këtilla joformale do të jenë praktikë e rregullt e që do të organizohen të paktën një herë në muaj.

Brifingun, gazetarët e shfrytëzuan edhe për t'u informuar në lidhje me aktualitetet në Komunë, në ditët e para të mandatit



të kryetarit Arben Taravari.

Ata u informuan nga kryetari se tashmë në postin ushtrues detyre në Ndërmarrjen publike "Komunalec" është caktuar Isak Lazami, ndërsa Sektorin e urbanizimit do ta udhëheq ekip treanë-

tarësh, në përbërje Sefedin Bilalli, Vanço Aleksoski dhe Bekim Aliu, ku të tre do të nënshkruajnë çdo dokument që del nga ky sektor.

Në lidhje me caktimin e ushtruesve të detyrës në shkollat fillore dhe të mesme, kryetari Taravari

njoftoi gazetarët se prej të hënës do të zhvillojë takime me kuadrin mësimor dhe prej tyre do të kërkojë që të paraqesin listë prej tre personash, prej të cilëve kryetari do ta përzgjedh njërin.

"Këtë do ta bëj me qëllim që të realizoj atë që kam pasur synim dhe që kam premtuar në fushatë, tas depolitizojmë dhe departizojmë arsimin si një sferë e cila tregon më të dashurit tonë, fëmijët, dhe që duhet të na sigurojë një të ardhme të ndritur", theksoi Taravari, duke nënvizuar se për emërimin e drejtorëve me mandat do të shpallen konkurse përkatëse dhe do të ndiqet proceduar e rregullt. Gazetarët, u interesuan edhe në lidhje

me konstituimin e Këshillit të Komunës, me ç'rast morën përgjigje se tashmë është siguruar shumica e nevojshme me tendencë që ajo të zgjerohet në të ardhmen e afërt.

"Presim që brenda ditëve në vijim, të marrim përgjigje pozitive edhe prej BDI-së në lidhje me konvokimin e mbledhjes konstituive të Këshillit të Komunës. Dëshiroj që të kemi një konsensus sa më të gjerë në vendimmarrje dhe kjo njëherit të reflektojë si shembull i mirë edhe për nivelin qendror", potencoi kryetari i komunës dhe shtoi se për kryetar dhe shtoi se për kryetar të Këshillit do të jetë i propozuar bartësi i listës së Aleancës për Shqiptarët, dr. Besim Memedi.



Nga Shkodra në Himarë, gjuha vjen e ndryshon, ose të paktën në drejtim të prapashitesave dhe të shqiptimit, sepse Himara pothuaj është greqizuar. Po kush do të jetë gjuha e vërtetë?

Shqiptarët që lexojnë Shekspirin – njoh nja katër a pesë -, prej disa javësh e kanë patur të pamundur për të mos sjellë e risjellë në mendje monologun e famshëm të Hamletit To be or not to be, that is the question. Për ta çështja që shtrohej ishte: A do të jetë Shqipëria një mbretëri e pavarur, apo serbi a greku, pavarësisht nga përpjekjet e Vienës apo Konsultës [Italisë] do të vërsulen për të copëtuar territorin e saj?

Më thellë në histori

Por, së pari, ç'është në të vërtetë Shqipëria? Pyetje e çuditshme, të themi. Por jo dhe aq sepse, megjithëqë hasen shqiptarë kudo në Ballkan, nga perëndimi i Vardarit gjer në rrethinat e Athinës dhe në pjesën veriore të Peloponezitet drejt Kanalit të Korinthit, Megarës dhe ishujve, ku që prej tre shekujsh ata përbëjnë bazën e popullsisë, prapë është tepër e vështirë të përcaktohen teoritikisht kufijtë e një vendi që do të mbante emrin Shqipëri.

Me përjashtim të kohës së Skënderbeut, shqiptarët Gjergj Kastrioti i Krujës, që luftoi si hero epopes kundër turqve të Muratit, nuk ka pasur kurrë mbretëri shqiptare. Dy a tre vjet pas vdekjes së tij, që ndodhi në Lezhë më 1466 [1468], trupat turke rinisën pushtimet e tyre.

Po ashtu, sa më thellë të futemi në histori, do hasim shqiptarët. Janë banorët më të hershëm të gadishullit dhe dorët, që pushtuan Greqinë në shekullin XII [p.e.s.] duke i dhënë fund qytetërimit kretë me themelimin e fuqisë së Spartës, ishin, brenda të gjitha gjasave, një fis shqiptar zbkruar nga Epiri drejt Jugut. Mbreti Pirro ishte shqiptar. Dijetari Momsen i përafroi me pellazgët dhe me fiset italoeste. Në atë kohë të largët, ata mbushnin krejt Maqedoninë.

Dhe maqedonët, që shtinë në dorë, me Aleksandrin në krye, Greqinë e Jugut, Egjiptin dhe Azinë, për aq sa njihet kjo e fundit, ishin pasardhës të tyre. Por, mjaft t'i thuash një heleni, as më shumë e as më pak që "Filipi, Aleksandri dhe Aristoteli ishin shqiptarë", e veç kur do ta shohësh të iki nga mendja apo të arrijë kulmin e shovinizmit.

Një mbrëmje, kur isha në Apiranton për ekskursion, i lodhur pas një marshimi tërë ditën në diell dhe nëpër dihare, apo në shtigje mushkash, me potinat që m'u bënë copë, pyeta një naksiot: "Ishulli juaj është i banuar që prej tremijë e pesëqind vjetësh,

Në shiritin e kohës

Louis Arnaud: Filipi, Aleksandri dhe Aristoteli ishin shqiptarë



apo jo? – Oh, ma ktheu, shumë më tepër! Naksiotët janë bij të pellazgëve, të atyre pellazgëve hyjnorë, siç thotë Homeri. – Bukur, thashë, po si shpjegohet atëherë që, pas kaq e kaq shekujsh, ju ende nuk keni ndërtuar në ishull as edhe një rrugë të vetme?" Më nguli ca sy të çuditshëm, por jo gjatë, për të më thënë: "Po ne këtu s'jemi në Europë dhe s'kemi nevojë për rrugë!"

Kurse tek shqiptarët, ca më keq akoma. Që prej katër mijë vjetësh a më shumë, ata flasin gjuhën e tyre dhe ende nuk e shkruajnë atë. Shqiptari kurrë nuk ka shkruar dhe kurrë nuk ka pasur një libër të tij, si fshatari grek apo muzhiku sllav. Nuk po flas për libra modernë botuar nga propaganda italiane, greke, madje edhe turke me synim politik.

Folkloristë të Athinës dhe Epirit kanë botuar me germa greke këngë shqipe dhe rrëfenja popullore. Por alfabeti grek i përdorur në shqip është i pamjaftueshëm, sepse i mungojnë dy a tre germa, j dhe v, për shembull. E njëjta vërejtje vlen edhe për turqit në përpjekjet e tyre.

Po e njëjta vërejtje dhe për librat shqip të shtypur me germa latine. Shqiptarë të greqizuar, që flisnin me lehtësi pothuaj të barabartë frëngjisht, greqisht e shqip, si lexuan një faqe të një broshure shtypur në Sicili, më thanë: "E kuptojmë si gjuhë, si të kuptonim greqisht me germa franceze. Për ne është një ortografi artificiale dhe shumë nuanca të shqiptimit shqip nuk jepen. Por librat shqipe që përdorin germa greke janë shumë më të vështira për t'u kuptuar".

“Një tjetër, me mendim më të moderuar, që kërkon thjesht Shqipërinë, dhe jo Shqipërinë e madhe, përshkon me gisht një vijë mbi hartë. “Shqipëria, thotë ai, kufizohet nga një vijë që do duhej të nisej nga pika më veriore e liqenit të Shkodrës, drejt Prizrenit, dhe që andej drejt Shkupit, dhe nga Shkupi shqiptar, duke lënë në të djathtë Manastirin, do t'i binte qark nga Jugu dy liqeneve të Ohrit e të Prespës gjer në jug të Haxhii-Sarandës përmbi detin Adriatik [Jon].”

Gjuha vjen e ndryshon

Dhe kësaj mungese të një alfabeti praktik shqip i duhet shtuar dëmtimi i kësaj gjuhe gjatë tridhjetë shekujsh nga ndërhyrje dukurish të tilla që e ndryshojnë pa kuptuar fonetikën, si dhe nga prurja e vazhdueshme e fjalëve greke, turke, serbe, italiane apo nga të gjithë popujt me të cilët shqiptarët kanë qenë në lidhje. Nga Shkodra në Himarë, gjuha vjen e ndryshon, ose të paktën në drejtim të prapashitesave dhe të shqiptimit, sepse Himara pothuaj është greqizuar. Po kush do të jetë gjuha e vërtetë? Ja pra vështirësitë për ortografinë. Dhe vetë kjo fjalë, "ortografi", a është shqip? Shohim kështu të kapen pas njëri-tjetrit filologë, gjuhëtarë dhe gramatikanë.

E megjithatë, gjuha shqipe ekziston, e pasur me poezi shpërthyes, me përralla gjithë fantazi, me këngë djepi gjithë ngrohtësi, me këngë vaji, satirike a humoristike, si në llojin e pastshit të famshëm të Prosper Merimesë, apo me këngë dashurie e luftarake, që kujtimet e çmuara i kanë regjistruar prej shekujsh të

paprekura në kujtesën e këtyre fshatarëve dhe malësorëve kaçakë që kurë nuk kanë shkruar a lexuar një rresht të gjuhës së tyre. Ja pse ekziston një Shqipëri.

Por këtë, nuk duhet t'ua kërkosh as grekëve që, ashtu si serbët e reduktojnë në një shirit toke midis liqenit të Ohrit dhe detit Adriatik, as diplomatëve të Romës apo të Vienës, që kanë arsyet e tyre për ta zgjeruar sa më shumë. Më treguan një hartë austriake ku fjala "albanien" filon në zemër të Malit të Zi, kur ky vetë aq i ngushtuar, dhe përfundon në det, më poshtë se ishulli i Korfuzit. Me një fjalë, krejt bregu nga gjiri i Kotorrit në gjirin e Artës.

Ç'përfitim për Austrinë sikur sulltani të kishte njohur me një marrëveshje të fshehtë protektoratin e saj në tërë këtë breg mbi treqind kilometra të gjatë!

Shqiptarët e idesë së madhe, sepse ka gjithashtu një ide të madhe shqiptare nuk do të guxonin të pretendonin aq shumë. Shqipëria e madhe për ta është një territor i kufizuar nga një vijë shumë e çrregullt, me pikënisje Artën e Epirit, për t'u ngjitur në drejtim të Manastirit, pastaj drejt

Shkupit, Gjakovës, dhe që andej drejt Shkodrës, kryeqyteti i tyre i vërtetë.

Dhe pretendimet e tyre mbështeten mbi një arsyetim shumë të habitshëm: "Gjithë vendi ku flitet shqip, është i yni, më thotë G., një shqiptar himariot. Në fakt, gjuha jonë, si më e vjetra, përherë e më shumë është prapsur nga gjuhët e reja, duke i lënë vendin greqishtes ose serbishtes. Nuk po flas për turqishten, ndaj së cilës është e kollajtë për t'u mbrojtur. E megjithatë, në Artë e në Janinë, madje edhe në perëndim të Manastirit e në Shkup flitet në radhë të parë shqip...", thotë G., dhe këtu kuptohet përfundim.

Nisur nga ky arsyetim, unë mund edhe t'i përgjigjesha: "Dafni, dhjetë kilometra larg Athinës, Menidhi, Eleusias [Elefsina] dhe ishujt më grekë nga vetë Athina, Salamina, Egineja dhe Porosi, ku vdiq Demosteni, qenkan ahere shqiptare". Po a ia vllente? Më mirë të dëgjoja. Sepse të paktën, kështu mëson diçka.

Shqipëria nuk e di ku ndodhet

Një tjetër, me mendim më të moderuar, që kërkon thjesht Shqipërinë, dhe jo Shqipërinë e madhe, përshkon me gisht një vijë mbi hartë. "Shqipëria, thotë ai, kufizohet nga një vijë që do duhej të nisej nga pika më veriore e liqenit të Shkodrës, drejt Prizrenit, dhe që andej drejt Shkupit, dhe nga Shkupi shqiptar, duke lënë në të djathtë Manastirin, do t'i binte qark nga Jugu dy liqeneve të Ohrit e të Prespës gjer në jug të Haxhii-Sarandës përmbi detin Adriatik [Jon]."

Po mua nuk më

takonte në këtë mes të flisja, për më tepër që, për mendimin tim të ndrojtur, vetë Shqipëria nuk e di ku ndodhet me saktësi brenda kufijve të saj, ndonëse ekzistenca e saj është mëse e sigurt.

Veçse është për të ardhur keq për paqen europiane dhe për zhvillimin industrial e tregtar të popujve të vegjël ballkanikë që Austria, e mbështetur nga ambiciet e pashpallura të aleates së saj, megalomanes Itali, dhe nga bajonetat gjermane mbron dhe nxit pretendime të tilla.

Që pas sukseseve të tyre të para dhe para se Austria ta shpallte tabu bregdetin adriatik, aleatët, për fat të keq, zunë e hallakateshin përherë e më shumë. Dhe, së bashku me ta, edhe ne. Malazetët merrnin vijën Alesio [Lezhë] – Skutari – Gjakovë, serbët vijën Shkup – Prilep – Durrës dhe grekët vijën Manastir – Vlorë. Shqipëria vazhdonte të ekzistonte me Elbasanin dhe fushën e tij të pasur vaditur nga Genusosi [Shkumbini], me Beratin, apo me Beogradin e arnautëve, aq shumë e tkurrur. Dhe ja ku Shqipëria shpall sot pavarësinë e saj dhe Austria ua ndalon serbëve dorën mbi Durrësin, dhe Italia, nga ana tjetër, grekëve mbi Vlorën. Të plotëfuqishmit e Londrës do kenë kështu një problem të koklavitur për t'u zgjidhur.

Si përfundim, Shqipëria ekziston në perëndim të Ballkanit. Është më e lashtë nga vetë Europa dhe prapë s'ka histori të vetën [si Shqipëri me kufij të përcaktuar]; ka gjuhë, po s'ka alfabet; ka kufij gjeografikë që e shfaqin territorin e saj sipas oreksit të palëve: ose sa një Mal i Zi, ose sa një Greqi. Dhe prapë, në disfavorin e saj. Po me vete, ajo ka Austrinë e fuqishme që e lakmon për të mbajtur Adriatikon, dhe Italinë që e dëshiron me të madhe për të mbajtur nën kontroll edhe flotën austriake. Sigurisht që është shumë nga ana e tyre.

Ne francezët, për qetësinë e Europës, për përparimin e shpejtë dhe të vazhdueshëm të gadishullit, dhe në interesin e vetë katolicizmit – dhe këtu e kam fjalën për Serbinë – ne duhet të urojmë një Shqipëri të vogël, por zotëruese të vetvetes, të mbrojtur dhe të siguruar ndaj tekave të politikës midis një Serbie tepër të zgjeruar dhe një Hellade të fortë e të lulëzuar. (Athinë, 19 dhjetor, 1912)



Veton SURROI

Ajo dhe ndryshimet

Të lehta janë shenjat se gjërat nuk do të ndryshojnë: për dallim prej çdo vendi evropian, pagat në sektorin publik janë më të larta se nga sektori ku i marrin, ai privat.

1. Dakord, nuk do të ketë ndryshime. Ky konstatim i ka, në formë të thjeshtësuar, dy lexime fundamentale. Njëri, për atë që u frikohet ndryshimeve, apo nuk i do, duhet të jetë lehtësues. I dyti, për atë që i do ndryshimet, duhet të jetë zhgënjyes.

Fjala shkencore për frikën nga ndryshimet, "Metathesiofobia", është aq e vështirë për ta mbajtur mend, saqë duket si të jetë e dizajnuar për të frikësuar çdokënd për ndryshime. Por, në Kosovë nuk ka nevojë të madhe për frikësim, sepse sistemi vazhdon të ushqehet me forcë që dekurajon apo pengon ndryshimin. Këtë e tregojnë edhe hapat e parë të Qeverisë së Kosovës. Mjafton për t'i lexuar shenjat e para në administrim, ekonomi e financa; ato janë indikatorë të drejtimit të mëtejshëm të pushtetit.

Ajo që u frikohet ndryshimeve mund të flejë rehat. Ajo që i do

ndryshimet ka arsye të brengoset.

2.

Ajo, qytetare e këtij vendi, që nuk i do ndryshimet ka arsye të jetë e qetë, sepse hapi i parë i kësaj Qeverie ka qenë themelimi i 21 ministrive dhe pastaj mbushja e tyre me militantë në formë zëvendësministrash e këshilltarësh. Në një ndarje të thjeshtë konceptuale pushtetesh, kjo formë e qeverisjes quhet ekstraktive (nxjerrëse), pra shërben për t'i përmbushur nevojat e pushtetarëve. Ata që janë pjesë apo afër pushtetit, pra ata që nuk duan ndryshime, kanë arsye për të mos u brengosur.

Ajo që i do ndryshimet ka, natyrisht, arsye pse të

brengoset. Qeverisja, e cila brengoset për veten, nuk ka kohë, energji e as invencion të merret me nevojat e të tjerëve. Kostoja e mospasjes së një qeverisjeje inkluzive, të pavarur nga feudet politike, e tejkalon koston e rrogave, mëditjeve, shëtitjeve, veturave e shpenzimeve të tjera të kota që i bën pushteti: Qeveritë nxjerrëse jo vetëm që shpenzojnë paranë publike, por edhe kohën e pakthyeshme.

Ajo që nuk i do ndryshimet ka arsye të jetë e qetë, sepse hapi i dytë i kësaj Qeverie ka qenë rrëfimi i intencave ekonomike nëpërmjet Projektbuxhetit të vitit 2018. Në formë të thjeshtësuar, projektbuxheti garanton se do të jetë i drejtuar nga mirëmbajtja e gjendjes ekzistuese, meqë nuk ekzistojnë indikatorë të ndryshimit në të. Nga brumi i njëjtë nuk do të dalë bukë tjetër.

Ajo që i do ndryshimet ka arsye të jetë e brengosur. Mirëmbajtja e gjendjes ekzistuese ka, së paku, edhe dy kosto ekonomike të shtuara, pos mungesës së zhvillimit. Pra, jo vetëm se nuk do të ketë më

shumë zhvillim, por synohet të shpenzohen mjetet e ardhmërisë (nëpërmjet rritjes së borxhit të brendshëm) dhe mjeteve të së kaluarës (nëpërmjet përdorimit të mjeteve nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës).

3.

Ajo që do ndryshime ka arsye plotësuese të brengoset. Ajo, në një ekonomi e cila është e pabarabartë ndaj shumicës së popullatës, pra që është diskriminuese, e ndien atë diskriminim edhe më shumë. Nëse punësimi është i ulët, te ajo është edhe më e ulët. Nëse arsimit është i keq, te ajo ndihet më shumë. Nëse perspektiva është e zymtë, ajo e ndien më tepër se ai.

Janë disa indikatorë që shërbejnë për të parë se a do të ketë ndryshim apo jo, dhe ja dy që mund të shërbejnë lehtësisht.

Njëri është kujdesi për "të vetët". Qeveria ka paralajmëruar se në politikën e pagave do të vazhdojë pa ndryshime, pra do të ketë rritje të pagave në sektorin publik. Kosova kështu do të vazhdojë të jetë i vetmi

vend në Evropë ku pagat në sektorin publik janë (në mesatare 555 euro), më të larta se në sektorin privat (ku paga mesatare është 416).

Kur një qeveri konsideron se paga në sektorin publik mund të rritet jashtë kriterëve ekonomike, atëherë këtë e shndërron në parim qeverisjeje. E pasojat e një parimi janë parë thellësisht në qeverisjen e PDK-së pas shpalljes së Pavarësisë, ku buxheti është konsideruar thesar privat/partiak dhe ku nuk ka ekzistuar as edhe një mendim minimal i politikave zhvillimore.

I dyti është shkalla e rritjes ekonomike. Në mënyrë që ajo të ketë perspektivë, vendi ka nevojë për shkallë të rritjes ekonomike prej 7 për qind. Me këtë shkallë bëhet ndryshimi në punësim; mbërrihet shkalla kritike ku ekonomia mund të integrojë në tregun e punës kontingjentin vjetor e të rinjë të papunë që e prodhon kjo shoqëri. Me këtë shkallë tregohet se e tërë shoqëria ka filluar të funksionojë: Qeveria është e përcaktuar për zhvillimin e sektorit

privat, rendi dhe ligji garantojnë afarizëm, sistemi shkollor prodhon mësim në vend të diplomave. Kjo Qeveri nuk ka mundësi as të mendojë për një shkallë të rritjes prej 7 për qind, prandaj kjo shifër nuk i afrohet majës së gjuhës.

4.

Modeli ekonomik i Kosovës është pak a shumë ynë. Sektori ynë më i fortë ekonomik, diaspora, na dërgon para. Ato para futen në konsum të brendshëm, i cili krijon një vlerë të shtuar. Ajo vlerë e shtuar krijon paratë e buxhetit, që rishpërndahen për rroga dhe në sektorin publik dhe në prokurim publik sektorit privat që është i afërt me klanin/partinë. Ky model krijon rritje prej 3 për qind dhe në agjendë publike presionin që vizat të liberalizohen në mënyrë që të iket sa më shpejt dhe lehtë nga ky vend; në mënyrë që të kemi më shumë para nga diaspora.

Ajo që do ndryshim ndoshta do të ketë rast vitin e ardhshëm të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare. Nëse ka, ndoshta dy pyetje më të rëndësishme mund të jenë: si të rriten rrogat në sektorin privat (tej atij publik) dhe si të rritet ekonomia me shtatë për qind në vit. (koha.net)



Antonio CALABRO

Një shekull nga 1917-a e revolucionit, 10 vjet nga kriza e madhe

Një shekull më parë ishte 1917, viti i Revolucionit sovjetik, një prej atyre ngjarjeve që shënjojnë humorin e kohës në të gjithë botën, një nga ato ngjarje që ndajnë epokat, në imagjinatën e përgjithshme, në "para" dhe "pas", simboli i një frakturë historike epokale, për të përdorur frazën e Fernand Braudelit. Dhjetë vjet më parë ishte fillimi i "Krizës së madhe" financiare dhe ekonomike, pasojat e të cilës i ndiejmë fort edhe sot. Në mes, një sezon plot turbullira ndryshimesh radikale dhe shpesh herë dramatike. Nëse të shkruash historinë "është t'u japësh fizionomi date", sipas mësimi të Valter Benjaminit, të mbash parasysh përsëritjet është zgjedhje e përpiktë dhe oportune. Historia, është e vërtetë, nuk është aspak ashtu si thuhet, magistra vitae. Por e rindërtuar në mënyrë kritike, ndihmon gjithsesi për të parë më mirë kuptimin e të kaluarës dhe të deshifrosh më me vetëdije,

Kthehemi kështu në kontradiktat e nëntëqindës, të shprehura sot në forma natyrisht të reja dhe më shqetësuese: mes demokracisë liberale dhe kapitalizmit në format e tij të ndryshme, mes inovacionit të teknologjisë së lartë dhe vlerave të lashta (dinjiteti i punës), mes mirëqenies së shtresave sociale më të forta dhe pasigurive të brezave të rinj, mes atdheve dhe botës. Reflektimet kritike mbi të gjitha aspektet e vitit 1917, tekta mbushet një shekull, mund të na ndihmojnë për të kuptuar pak më mirë edhe të sotmen

aktualitetet tona kontroverse.

Kohët e fundit, mes agimit të shekullit të shkurtër dhe ditëve të sotme të krizave e ndryshimeve, Nëntëqinda u largua me rënien e Murit të Berlinit dhe shpërthimit nga brenda të peran-

korisë sovjetike në 1989, primatin kontrovers amerikan në momentin e triumfit të tregut të lirë dhe demokracive liberale kundër Ariut komunist, globalizimin e pandalshëm, përhapjen gjithnjë e më të shpejtë të teknologjive digjitale që ndryshojnë prodhimet, produktet, tregjet dhe konsumet. Dhe sërisht, me bumin ndërkomëtar të financës dhe instrumenteve të saj të shkëputura nga "ekonomia reale". Dhe mbërrimë në 2007-ën tek kriza e madhe. Deri në ditët e sotme. Shekulli i shkurtër nis me Luftën e Madhe 1914-1918: e gjatë, shkatërrimtare, radikalisht e ndryshme nga e kaluara, për shkak të futjes në skenën e luftës të teknologjive të reja ushtarake (motorizimi, avionët, mekanika e armëve, kimia, gazi, financa, logjistika etj) dhe për nga dimensionet masive të përplasjes, pasojat e të cilës përfshijnë si kurrë më parë, shtresa të mëdha të popullsisë civile.

Dimensione për t'u rishtruduar. Dhe pikëpyetje të epokës që mbeten absolutisht bashkëkohore, si mund ta zbulojë kush merr në dorë "Pasojat ekonomike të paqes", pamfletin brilant të John Maynard Keynesit në vitin 1919, për të dokumentuar gabimet e Traktatit të Paqes të Versajës, si dhe denoncuar pasojat negative të poshtërimit të Gjermanisë dhe egoizmeve nacionaliste të Britanisë së Madhe dhe Francës, si dhe afirmimit sipërfaqësor të hegjemonisë së SHBA (do të pasonte Lufta e Dytë, me serinë e saj të tragjeditive).

Një Keynes mbi të cilin duhet reflektuar edhe sot, në këto stinë neoneoliberalizmas, proteksionizmas dhe ribërjesh të influencave globale politike, ushtarake, ekonomike. Pikërisht në rrafshin e ndërthurjes mes politikës dhe ekonomisë, Kriza e Madhe na ofron shumë tema ende të vlefshme. Tema e parë ka të bëjë me "rrugën e lirë" që politika i la "Reagonomics" dhe

Chicago Boys të Friedmanit (ideologjia e tregut si vlerë absolute dhe e përgjithshme, dhe jo si instrument i konkurrencës së lirë të mirë-rregulluar) dhe më pas nga supozimi clintonian "It's the economy, stupid!", dhe deri tek ekspansioni i financës dhe fitimit të shpejtë dhe të pamatë ("Babëzia është e mirë", sipas batutës së Gordon Mekko-Michael Douglas në "ëall Street"). Ja pra: Kriza e Madhe, si borxh i tepruar i kamufluar me "derivate" dhe "subprime", çekuilibra ekonomikë dhe socialë të patolerueshëm, pabarazi. Pasojat janë ende aktuale. Diskutimet e këtyre ditëve në Forumin Ekonomik të Davosit janë jehona e pangatërrueshme. E gjithë bota është e futur tashmë në turbinën e një transformimi, pa rezultate të sigurt.


"Nuk i bëjnë më ashtu", shkruan The Economist në numrin që sapo ka dalë, duke shtuar se "prodhimet në botën e pasur ka ndryshuar në mënyrë dra-

matike, që nga ditët e punimit të metalit. Bashkë me të, edhe vendet e punës". Ja një temë e rëndësishme: marrëdhënia mes teknologjive inovative dhe vendeve të punës që humbin, nevojat për aftësi të reja dhe dinamike profesionale dhe mungesa e ekuilibrave socialë, respekti për logjikën e tregut (konkurrenshmeria, ndërkomëtarizimi) dhe fitimit për kompanitë, si dhe problemet e punësimit, pagave, mirëqenies. Por edhe raporti konfliktual mes globalizimit që përparon (me shanse dhe hije) dhe rilindjes së frymave nacionaliste (Trump, Putin, Erdogan, nënkultura e Brexit, egoizmat e vendeve të shumë në brendësi të BE-së). Kthehemi kështu në kontradiktat e nëntëqindës, të shprehura sot në forma natyrisht të reja dhe më shqetësuese: mes demokracisë liberale dhe kapitalizmit në format e tij të ndryshme, mes inovacionit të teknologjisë së lartë dhe vlerave të lashta (dinjiteti i punës), mes mirëqenies së shtresave sociale më të forta dhe pasigurive të brezave të rinj, mes atdheve dhe botës. Reflektimet kritike mbi të gjitha aspektet e vitit 1917, tekta mbushet një shekull, mund të na ndihmojnë për të kuptuar pak më mirë edhe të sotmen. (HuffingtonPost.it - bota.al)

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

- 3. Ndajfolje, për
- 5. Ish grup muzikor anglez (Xh. Majkëll)
- 7. Vegël automjeteve për ngadalësimin e lëvizjes
- 9. Që ka të bëjë me ajrin
- 10. Emri i fabulistit të njohur grek
- 12. Amënor
- 13. Simboli i iridiumit
- 14. Këmbësor
- 18. I vogli i dhisë
- 20. Shok, jaran
- 21. Inicialet e gazetarit Arslani
- 22. E lëshon poshtë
- 24. Lidhja Socialiste
- 25. Dru i hollë, ku varen suxhukët (sh.)
- 27. Nokaut
- 28. Zhurmë e madhe për diçka
- 29. Element kimik (V)
- 32. Fshat në Rrethin e Tepelenës
- 33. Këngëtarja Baraku
- 35. E dyshuara që nxirret përpara gjyqit
- 37. Është Lat.)
- 39. Ujdhesë koralesh
- 40. Pjatë e thellë
- 41. Radhit (librin)
- 42. Lojë shoqërore japoneze
- 45. Monedha shqiptare
- 46. Ujdhesa e Odiseut
- 49. Mëkat
- 50. Legjendë.




VERTIKALISHT


- 1. Gjenerata, breznia
- 2. Dëshirë
- 3. ai që i bie në dorë dikujt, viktimë
- 4. Autori frëng, de Balzac
- 5. Hekur për të hekurosur rrobat (krahin.)
- 6. Futbollisti turk, Emre
- 8. Autori kosovar Prokshi
- 9. Falja e dënimit
- 11. Shko
- 12. Inicialet e akademikut Aliu
- 15. Zanore dhe bashkëtingëllore
- 17. Simboli i berkeliumit
- 19. Emër arab
- 23. Ish politikani rus, Brezhnev
- 24. Ndajfolje, urtë e butë
- 26. Radio televizioni italian
- 29. Ish futbollisti italian, Xhanluka
- 30. Aktorja amerikane, Bening
- 31. Qëllim i lartë
- 32. E mund në një luftë apo në një ndeshje
- 34. Ushtar (turq.)
- 35. Futbollisti kamerunian, Semjuel
- 36. United States
- 38. Bashkë
- 43. Rregull
- 44. Lojë me 64 fusha
- 47. Gaz që del nga zjarri
- 48. Shtresë.

Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë





për më të rinjtë

TETËKAHËSHI- ondulimi

- BRUSHA
- FLOKTARJA
- KAÇURRELAT
- MINDILI
- MPREHËSI
- NGJYROSJA
- PASQYRA
- PESHQIRI
- QETHJA
- RIMELI
- SPREJI
- TULLACI
- USTAI
- SHKURTIMI



G...SH...

K...H...

Z...Y...T



M...K...



B...S...



Q...P....

Gjeni 24 shprehjet që kanë të bëjnë me ondulimin (disa janë dhënë me figura). Në fund, me 13 shkronjat e mbetura do të fitoni emrin e punëtorisë që merret me këto aktivitete.

T	A	P	I	T	T	A	T	A	A
U	R	E	J	Ë	A	T	Ë	J	SH
LL	K	SH	E	F	L	E	K	TH	U
A	E	Q	R	Y	E	C	O	E	R
C	J	I	P	L	RR	N	L	Q	B
I	M	R	S	Y	U	I	F	R	T
S	K	I	A	Z	Ç	P	I	Ë	N
B	R	A	LL	T	A	S	R	O	GJ
Q	E	R	P	I	K	Ë	T	SH	Y
P	H	R	N	U	SH	O	K	O	R
A	R	N	B	R	S	U	L	D	O
S	I	U	Ë	E	R	T	L	F	S
Q	M	G	I	T	R	M	A	I	J
Y	E	M	I	N	D	I	L	I	A
R	L	M	V	E	T	U	LL	A	T
A	I	I	S	Ë	H	E	R	P	M



F.....

V...LL..



B...B...



M...K...



DALLIMET

Gjeni 6 dallimet në fotografitë e mëposhtme!



TRANSFORMIMI


Transformoni DREKËN në LIMON duke zëvendësuar nga një shkronjë.

1	D	R	E	K	A
2					
3					
4					
5					
6	L	I	M	O	N



FIGURA E FSHEHUR

Ngjyrosni fushat që përmbajnë pika që tëzbuloni figurën e fshehur!



SUDOKU "killer"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Numrat e dhëna paraqesin shumën brenda sipërfaqes me vija të ndërprera.

3	2	9	13	21	9	10	6	1	15
			9	13					
11	15			11	1	11	9	4	
		11			27				
12		4		7		13	5		9
16			8		18	6	10		
17			5		6				
4		1	22	19		18	12		5
6				9			8	9	

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejné rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".

6				5				3	
7		1							
					8				
				5			6		
		7							
			3	8					
									9

KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

1-	5	3-	168x	12x	8-	70x	7
17+				1	5-	120x	
5-		224x	3	5-	2-		2
3+	48x		8	9	2		
2	8	30x		23+	5-		13+
7	4-	3+		8	45x		9
16+		9+		3+	42x		
	7+	8-	14+	2	1	14+	6
			5	2+		42x	
							4

ARUKONE

Bashkoni me vija numrat e njëjtë. Vijat nuk guxojnë të priten dhe duhet të përfshihen të gjitha fushat!

5	7	2		4				
				4	8		9	
		7						
6					1			
				8				
2		5						
		6						
1					3	9	3	

NONOGRAM

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat me presje (rreshtet) dhe ato njëri nën tjetrin (kolonat), tregojnë se ka pauzë në mes të fushave të nxira.

				1				
				1	1			3
				3	1	1	1	1
1	3							
1								
1	1	1						
3	1							

KRIPTOGRAMI

Kriprogrami zgjidhet sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë". Në fushat e hijëzuara shënoni emrin dhe mbiemrin e këngëtares sonë në foto.


1	2	3	4	5	6	7	6	2	8	2	9	4
10	11	4	8		3	2	5		10	12	2	11
3	2	13		11	4	14	6	7		2	3	15
16	17		18	10	13	4	11		12	17	2	5
10	5	2	17						17	2	7	4
11	6	19	15						6	7	6	3
2		15	13						16		7	4
	2	20	7						4	5		9
13	12	6	17						13	4	17	21
12	2	17	2						12	17	4	5
10		4	22						10	16	2	
17	1		4						9	4		16
7	10	12	10						4	7	10	17
16	17	4	3						7	2	17	6
2	16	17	4		16	4	10	16	2		2	23
20	4	15		24	15	5	8	4		2	19	4
25	10	3	4		15	7	10		5	8	15	20
2	3	21	7	2	17	4	26	6	1	15	27	7



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27					

MOZAIKU

Plotësoni mozaikun duke i bartë fjalët e dhëna. Në fushat e hijëzuara shënoni kryeqytetin e Azerbajxhanit (në foto).



- 2 shkronja:
AP, IL, ISH, MS, TI, TLL
- 3 shkronja:
AJS, ARRA, IMA, LUR, LLOM, MAM, MAT, NAM, NUR
- 4 shkronja:
AJET, AKULL, BUKA, KUIN, MURA, OLLUK, URAL
- 5 shkronja:
FANAR, LLOKUM, ROMUL, SHKURRE
- 6 shkronja:
ARATIM, LUTJET, METALI, OKULAR
- 7 shkronja:
BARITON, BATERIA
- 8 shkronja:
KALIFATI, KONTROLLI, STILISTI, TELEPATI.

GOLFI enigmatik

Në lojën e golfit fitues është lojtari i cili me më pak të goditura arrin ta fusë topin në gropëz. Edhe te golfi enigmatik, që të dilni fitues, duhet të tuboni sa më pak pikë.

Te GOLFI enigmatik

- nëse formoni fjalë me të gjitha shkronjat e dhëna, në tabelë shënoni 1 pikë;
- nëse formoni fjalë me një, dy apo tre shkronja më pak, në tabelë shënoni 2 pikë;
- nëse formoni fjalë prej pesë shkronjave, në tabelë shënoni 3 pikë;
- fjalët deri në katër shkronja nuk merren parasysh dhe në tabelë shënoni 5 pikë.

SHEMBULL

SKATIPËL	PIKË
Një goditje	PLASTIKË 1
Dy goditje	SPITAL 2
Tre goditje	LAPSI 3
Dështim	X 5

- Një goditje = të gjitha shkronjat
- Dy goditje = deri minus tre shkronja
- Tre goditje = fjalë prej 5 shkronjave
- Dështim = katër shkronja e më pak

TADShASËR	
1	Një goditje
	Dy goditje
	Tre goditje


AKEMLERA	
2	Një goditje
	Dy goditje
	Tre goditje

RUSLUTEFU	
3	Një goditje
	Dy goditje
	Tre goditje

ASEMTROT	
4	Një goditje
	Dy goditje
	Tre goditje

FONKISENI	
5	Një goditje
	Dy goditje
	Tre goditje

TABELA	1	2	3	4	5	GJITHSEJ
A						
B						



Sudoku

i lehtë

				1				3
	8			2				
	2				5			
3					4	8		
5				7				
			9		6			1
1		8	3					
								2
								7

mesatar

1				6				9
5	9			7				8
			5					
				7	5			
	1	5	8		6	4	7	
	7		4	1				3
					3			
2	3		7					1
4				2				5
								7

i vështirë

					8			6
4	8	7	3					2
1				7				8
	3							5
6		5				2		3
		1				7		
	6			2				5
	5				4	8	3	2
1		9						

MENSUR MAMUTI	MUSLIMAN I VENDEVE SLLAVE SHKR. AUSTRAL. LIN VAN	P	SHIH FOTON	TRESH MUZIKOR	QË LIDHET ME NJË POPULL A ME NJË KOMB	TENISTI FRANCEZ JANIK	TREGIM I S.G.														
REVISTA NË CILËN BËTONTË S.G.																					
I BËN DASËM DJALIT APO VAJZËS																					
DHOMAT E UDHËTAREVE (te trenat)																					
KOHA E LIRË	VENDI KU BURON UJI ROMAN I S.G. "PLAKU I..."					SPANJA BIME UJORE (shq.)															
ITALI		IMPULS URA E MAKOMBIT NË NJU JORK (mbi lumin Harlem)		QYTET NË FRANCE ILINIUM																	
LLOJ RITMI I MUZIËS BLUZ (me piano)						L.D. REGJISORI UELLS															
SPECIALISTE E UROLOGJISË STADIUM								AVANS GJATË BLERJES DE MOPASAN	K	MODELJA HILTON SPECIALITET ME KOS	P	LOKAL	EGJIPT								
S					GRUA QË BËN PUNËT E SHTEPISË LLOJ DRURI																
FARAON EGJIPTAS (PIRAMIDAT) HUMB JE DËMTIM						VECORITË, SHENJAT MIZORI															
D					QYTET NË BULLGARI QË U PËRKET TATIMEVE									NJË KLUB GREK KILO TONË					ERA E KËNDSHME		
PËLHURË MËNDAFШИ (shq.)										PREZANTUESI ADI PËRËMËR VETOR											
GRUP I VOGËL BESIMTARËSH ME NJË DOGMË TË VEÇANTË	KRAHINË NË KOSOVË GRUPORE, PUNË EKIPI					ZONAL ADVANCEMENT TOURNAMENTS GJ					TEMPO BANORET E PEJES			OREGON FUTBOLLISTI MEHMEDI							
S						ZBULOJ SHTET NË SHBA								DETEKTIVI I AGATË KRISTIT, HERKUL AUTORI YNË HATIPI							
AKTORI STIV MEK MBARIMI I BOTES						QYTET NË HOLANDË LLOJ LUNDRE (e gjatë 10 m.)								A.J. DËBOJ					MERCHANT NAVY ASSOCIATION PJESË E AUTOMJETEVE		
VEPËR E S.G.																				FRYMË, RYMIM AJRI	
OKSIGJEN		LUMË NË SLOVENI O.Z.						VENDEË KNOCK OUT												ENERGJI ARGJEND	
SHKRONJË GREKE					ORENDITË, ZBUKURIMËT BELGJIKË															ARGON REZE	
E REALIZOJ, E KRYEJ NJË URDHËR																					PLLAKË PËR IDENTIFIKIM TE AUTOMJETEVE



SUDOKU "Killer" | **SUDOKU ">"** | **KENKEN** | **ARUKONE** | **NONOGRAM** | **TRANSFORMIMI** | **SUDOKU**

SKANDI | **KRIPTOGRAMI** | **FIGURA E FSHEHUR** | **PER ME TE RINTE** | **KAKURO** | **FJALEKRYQI KLASIK**

IGJIDHET



Muri i Berlinit

U shemb, por jehona e betejave nuk u shua

Eshtë e vështirë të mbivlerësosh se çfarë mrekullie ishte që këto diktatura u shembën kaq paqesisht në 1989-ën. Në shekullin 20, kontinenti ynë ishte shkretuar nga dy luftëra. Pikërisht prej këtij shkatërrimi u ndërtua themeli i një projekti të përbashkët evropian të paqes dhe begatisë, një arritje që – pavarësisht të gjithë problemeve që ka sot – mbetet politika më e mirë e sigurimit, që ne kemi kundër rënies në përsëritje



Si sot 28 vjet më parë, harta e një kontinenti nisi të ribëhet. Përkundër pritshmërive, ndryshimi nuk po vinte për shkak të një prej atyre konfrontimeve të tmerrshëm mes shteteve, që kishin përcaktuar kufijtë e Europës dhe të shekullit 20 deri në atë kohë. Në vend të armëve dhe bombave, ishin çekanët që vërtiteshin prej civilëve që krijuan skenën për një Europë të re dhe për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik – çekanë që shkëpusnin e pllakave të mëdha të betonit, të cilat prej dekadash kishin tharë zemrën e Berlinit, një simbol në dukje i pashkatërrueshëm i shtypjes dhe i

ndarjes së Europës në dy blloqe.

Ndërkohë që Europa përpiqet në atë që duket si një tjetër luftë e ftohtë me Rusinë, ndoshta është koha të reflektojmë për mësimet e 1989-ës. Njëri është që stabiliteti – pikësëpari, ai i regjimeve autoritarë – nuk është asnjëherë një siguri e përjetshme. Demonstruesit e rinj në Hong Kong, të cilët kanë kërkuar liri e demokraci në muajt e fundit, padyshim që e kanë këtë gjë në mendje. Një tjetër mësim është se sa larg kishte shkuar planeti me ndërlidhjen, shumë kohë përpara se të shfaqej Interneti. Revolucionet paqësorë të vitit 1989 u bënë të mundur sepse Mikael Gorbaçovi refuzoi përdorimin e forcës, për arsye se ai i frikej turp

ndërkombëtar që kish rënë mbi udhëheqjen kineze, kur kjo shtyp kryengritjen e sheshit të Tiananmenit pak muaj më herët.

Por shumëkush në aparatat sovjetik u godit prej një poshtërimi drithëruar – tek shihnin të shastisur se si, përgjatë verës dhe vjeshtës, mijëra Evropianë lindorë shtyheshin në vrimat që zgjeroheshin në perden e hekurt. Një lejtnant në atë kohë i panjohur i KGB-së, i quajtur Vladimir Putin, ndiqte i dëshpëruar gjithë këto ngjarje që nga baza e tij në Drezden. Putini do të kujtonte më vonë në librin e tij me kujtime, “Në vetë të parë”, sesi kishte pritur më kot bashkë me kolegë të tjerë në zyrat e KGB-së, për reagimin e “Qendrës” (Moskës). Ishte kjo

traumë, e shkaktuar nga të qënurit dëshmitar i shpërbërjes së një rendi të fuqishëm sovjetik prej pushtetit të popullit, që do ta shtynte më vonë Putinin ta përshkruante serinë e ngjarjeve të 1989-1991-shtit si “katastrofën më të madhe gjeopolitike të shekullit 20”. I keqmenaxhoi apo jo Perëndimi marrëdhëniet e tij me Rusinë gjatë dy dekadave që pasuan, impakti psikologjik mbi njeriun që ka bërë më shumë se kushdo tjetër për të rikrijuar tensionet lindje-perëndim në kontinentin evropian, është shumë i fortë.

Në këndvështrimin që Putini ka për botën vazhdon të kumbojë tronditja e 1989-ës. Në shumë drejtime, aspiratat evropiane të qytetarëve ukrainas, të

demonstruara sërish në rezultatit e zgjedhjeve për parlamentin e ri në Kiev muajin që kaloi, janë vazhdimësia e frymës se përçuan shtetet evropiano-lindorë 25 vjet më parë. Ky është një paralelizëm që Putini e konsideron jo vetëm irritues, por edhe si kërcënim. Dërgimi kohët e fundit i avionëve bombardues rusë mbi qiejt e Europës, madje deri mbi Portugali, është një shenjë që zakonet e vjetër vështirë se harrohen.

Eshtë e vështirë të mbivlerësosh se çfarë mrekullie ishte që këto diktatura u shembën kaq paqesisht në 1989-ën. Në shekullin 20, kontinenti ynë ishte shkretuar nga dy luftëra. Pikërisht prej këtij shkatërrimi u ndërtua themeli i një projekti

të përbashkët evropian të paqes dhe begatisë, një arritje që – pavarësisht të gjithë problemeve që ka sot – mbetet politika më e mirë e sigurimit, që ne kemi kundër rënies në përsëritje.

Ndonëse sot është lehtësisht i kritikueshëm, ideali evropian ndihmoi shtetet të transformoheshin për më mirë. Më pak se një vit pas rënies së Murit të Berlinit, Gjermania Lindore i ishte bashkuar komunitetit, e ribashkuar me perëndimin. Dhe në të vërtetë, në vitet që pasuan, Europa udhëhoqi një zgjerim i cili afrooi shumë më tepër shtete, në 2004, 2007 dhe 2013, pasi kishte shërbyer si burim frymëzimi për reformat dhe demokratizimin. Nacionalizmi revizionist që buron nga Rusia sot ka si objektivi që të pengojë përhapjen drejt lindjes të vlerave dhe institucioneve evropiane. Armiqtë e Ukrainës paralajmërojnë për brishtësinë e premtimit “Kurrë më!” të bërë ditën e Armëpushimit. Në qendër të hapësirës evropiane, po krijohet një tjetër vijë ndarëse. Shkelja e sovranitetit të Ukrainës nga armët e rusëve dhe aneksimi i Krimesë janë dëshmi e një rendi evropian ende të pavendosur. Fragmentet e Murit janë suvenirë sot, por betejat që çuan në shembjen e tij kanë një jehonë që vazhdon të zgjasë.

Malta

Në rrugën drejt një ishulli të mafias?

Më së voni më 16 tetor 2017 shteti mesdhetar Malta humbi pafajësinë e tij në sytë e opinionit ndërkombëtar. Gazetarja 53 vjeçare Daphne Caruana Galizia u vra me një veturë bombë. Më parë ajo kishte marrë disa herë kërcënime me vdekje. Ajo kishte investiguar lidhur me implikimet e mundshme të familjes së kryeministrit Joseph Muscat në biznese jo transparente financiare.

Çfarë po ndodh në shtetin ishull të Maltës, që për shkak të anëtarësisë në BE duhet të përmbushë kritere të larta të shtetit ligjorë Dyshimet nuk vijnë nga hië. Komisioni i BE-së më 2016 analizozi anëtarësimin e Maltës dhe arriti në konkluzionin, se krahasuar me të gjitha vendet e tjera anëtare të BE-së, “mediet ndodhen jashtëzakonisht fort në duart e partive politike”, dhe se “për shkak të mungesës së masave të rregullimit dhe vetërregullimit” pavarësia redaksionale në media është e dobët.

Vrasja e një gazetareje investigative, besojnë gjithnjë e më shumë malteze, tregon që sistemi në shtetin ishull nuk është në rregull. Qytetarët nga qeveria aktuale nuk presin as zbardhjen e rastit dhe as përmirësim.

Medie të dobëta, ekonomi e fortë financash

Por në Maltë është e fortë ekonomia e financave. Ishulli klasifikohet si parajsë tatimore; në këtë drejtim nuk ka ndryshuar asgjë anëtarësimi në BE. Përkundrazi: qëkurse Malta është anëtarësuar në BE në vitin 2004 dhe me mundësitë që lidhen me këtë në tregun e brendshëm dega e financave është në rritje. Kryeministri Muscat në të kundërt në një intervistë me agjencinë e lajmeve Reuters tha, se: “Sektori i financave është po aq



transparent, solid dhe konform rregullave si edhe gjithë të tjerët në Europë.”

Shumë malteze, por edhe vëzhgues nga jashtë shohin në kombinimin mes medieve të dobëta dhe lobit me influencë të kapitalit një problem strukturor. Madje ata as nuk befasohen, që policia në sfondin e një vale atentatesh duket e pafuqishme: Dy vitet e kaluara ka pasur gjashtë atentate me vetura bombë në Maltë – deri më tani

askush nuk është akuzuar.

Mosbesim ndaj sistemit të Muscat-it

Shumë malteze nuk i durojnë dot më këto rrethana dhe mendojnë, që demokracia ka marrë fund. Gjatë një demonstrate të dielën e kaluar (30.10) në pankarta shkruhej “Ne nuk mund të na bëjnë të heshtim” dhe “Vendi ynë meriton më mirë”. Bloggeri

Jacques Zammit tha në një fjalim gjatë demonstratës, se “shteti nuk punon për vendin, por për qarkun e brendshëm të pushtetit.”

Familjet e të vararëve i kërkojnë kryeministrit të japë dorëheqjen. Ai e ka kthyer Maltën në “ishullin e mafies”. Ata nuk besojnë më tek drejtësia nën këtë qeveri. Djemtë e Galizias në një postim në Facebook shkruajnë: “Nuk mund të sjellin tani drejtësi ata, që aq kohë sa ne kujtojmë

nga e kaluara, vetëm janë përpjekur ta bëjnë të heshtë nënën tonë.”

Vëmendje ndërkombëtare

Kritika të ashpra vijnë ndërkohë nga mbarë Europa. Komisioni i BE-së i bëri thirrje Qeverisë malteze që jo vetëm të zbardhë vrasjen, por edhe të zgjidhë “problemet e mundshme strukturore” me shtetin ligjor. “Sytë e Europës janë drejtuar nga autoritetet e Maltës”, shkruan zëvendës-presidenti i Komisionit Frans Timmermans.

Ministri i Brendshëm i Maltës, Michael Farrugia ka thënë, se policia mund të kryejë të gjitha hetimet e nevojshme. Kryeministri Muscat ka vënë në dispozicion një shumë shpërblyese prej një milionë eurosh për atë që jep dëshmi për kapjen e dorasit. Megjithatë mosbesimi dhe presioni është aq i madh, sa ndërkohë Muscat pranoi që të shkojnë në Maltë hetues nga Europol dhe FBI-ja për t’u ndihmuar kolegëve të tyre malteze.



Serbëve u ofrohen deri në 30 mijë euro për ta votuar ushtrinë e Kosovës

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, thotë se "është i qartë qëllimi i shqiptarëve dhe i një pjese të faktorit ndërkombëtar që ta dobësojë pozitën e Serbisë dhe të Listës Serbe në Kosovë". Vučić ka parashikuar se ky presion do të vazhdojë edhe më tej, edhe te deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta pranojnë themelimin e Ushtrisë së Kosovës, njoftojnë mediat serbe. "Mund të ketë edhe raste kur njerëzve do t'u afrohen shuma prej 20-30 mijë euro që serbët të marrin pjesë në formimin e Ushtrisë së Kosovës, me qëllimin që ta dobësojë pozitën e Serbisë dhe popullit serb", citohet të ketë thënë ai.



Presidenti Thaçi themelon Urdhrin "Shotë Galica"

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se viti 2017 shënon përvjetorin e 90-t të vdekjes së njërës prej figurave më të ndritura të historisë kombëtare, Qerime Halilit, të njohur me emrin luftarak Shote Galica. Kreu i shtetit theksoi se vdekja e Shote Galicës përkufizohet me fatin e heroit tragjik, një fund jo i rrallë i figurave të mëdha, që jetën e përfundojnë padrejtësisht në mjerim social dhe ekonomik, pa fajin e tyre. Ai theksoi se Shote Galica vdiq në Shqipëri në kushte të rënda pa përkujdesje institucionale. "Përkundër fundit tragjik, Shote Galica u shndërrua në simbol të gruas besnike ndaj atdheut, të heroinës që lufton për liri, të luftëtares së gatshme për sakrificë. Shote Galica u bë simbol i kontributit të heroinave të heshtura të kombit, të nënave, bijave, vajzave dhe grave që në çdo periudhë historike përbaluan të mirën dhe të keqen krahas familjes dhe kombit. Shote Galica është simbol i krenarisë dhe dinjitetit të gruas shqiptare: Shote Galica është simbol i nënave, grave dhe motrave që gatuan, ushqyen, pastruan dhe shëruan luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare kudo në Kosovë e më gjerë. Shote Galica është simbol i nënës shqiptare, i asaj nëne që lindi Shote Galicën, Azem Bejtën, Shaban Polluzhën, Adem Demaçin, Jusuf Gërvallën, Adem Jasharin, Zahir Pajazitin, Xhevë Lladrovcin dhe shumë e shumë luftëtarë e luftëtare, dëshmorë, heronj e heroina që ranë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", tha Thaçi. Presidenti Thaçi tha se më rastin e 90 vjetorit të vdekjes, bazuar në kompetencat ligjore dhe kushtetuese ka themeluar dekoratën "Urdhri Shote Galica", me të cilën do të dekorohen figura të shquara të kombit për sakrificë dhe liri.

Një familje shqiptare prek zemrat e berlinezëve. Familja e Xhezo Ajazajt ndodhej para dëbimit, por reagimet bën që senatori i Berlinit të ndryshojë mendje. Rreziku nuk ka kaluar, por të paktën rasti do të rishqyrtohet

Kur kthimi i një familjeje shqiptare refuzohet edhe nga një politikan i AfD-së, partia ekstremiste e djathtë gjermane që njihet për parullat e saj kundër të huajve dhe islamit, atëherë duket se diçka nuk shkon me politikanët e landit të Berlinit. Georg Pazderski, (AfD), i njohur me rastin e familjes Ajazaj u shpreh pro qëndrimit të familjes shqiptare, shkruan gazeta gjermane "Bild", duke theksuar se AfD "do të mbështeste votën e komisionit për shqyrtimin e rasteve të veçanta".

Megjithëse shpesh në politikën gjermane dëgjohej refreni se kush është integruar e ka punë të sigurt mund të jetojë në Gjermani, realiteti për emigrantët është më i vështirë. Sido mos të ardhurit nga Ballkani kthehen nuk kanë asnjë shans për njohjen e azilit. Shqipëria e Kosova janë vende të sigurta origjine. Shpresa e vetme për të ardhur në Gjermani mbetet ardhja me një vizë pune. Xhezo Ajazaj e ka këtë punë ndërkohë, familja është integruar në jetën gjermane, ndërkohë në Berlin ka lindur edhe vajza e tretë e Xhezo Ajazajt. "Vajzat flasin më mirë gjermanisht se shqip", ka rrëfyer ai për mediat gjermane.

"PLLAKASHTRUESI MË I MIRË"

Para gati tre viteve 31 vjeçari erdhi në Gjermani bashkë me familjen e tij. Tani ai punon me kontratë të plotë tek një firmë gjermane si pllakashtrues. E la Shqipërinë, "se nuk kishim asgjë", është shprehur 31 vjeçari për Berliner Zeitung që kërkoi një jetë më të mirë në Gjermani. Shansi i tij me sa duket erdhi edhe për shkak të punës së palodhshme të Xhezo Ajazajt, i cili arriti të kishte një punë me kontratë të paku-



Familja e Xhezos mund të "shpëtojë"!



Drejtuasi i firmës së ndërtimit ku punon ai, Martin Habeland e cilëson atë "pllakashtruesin më të mirë, që ka" dhe se ai punon sa për tre vetë, shkruan "Berliner Zeitung". Ai u angazhua shumë që familja dhe punëtori i tij më i mirë të qëndrojnë në Gjermani.

fizuar. Drejtuesi i firmës së ndërtimit ku punon ai, Martin Habeland e cilëson atë "pllakashtruesin më të mirë, që ka" dhe se ai punon sa për tre vetë, shkruan "Berliner Zeitung". Ai u angazhua shumë që familja dhe punëtori i tij më i mirë të qëndrojnë në Gjermani.

TË SHIHET SI RAST I VEÇANTË

Rasti i Xhezo Ajazajt u kthye në temë debati në politikën e landit të Berlinit. Politikanët e partive të ndryshme në parlamentin e landit kanë kërkuar që

familja të qëndrojë, për shkak se është integruar dhe. Politikani i partisë liberale, FDP, Sebastian Czaja shprehet se "imigrantët e integruar në mënyrë të suksesshme pas viteve me tolerim qëndrimi dëbohen, ndërkohë që rrihet duarkryq për ata që refuzojnë integrimin". Ndërsa i ngarkuari i Berlinit për integrimin, Andreas Germershausen, shprehet se ai dëshiron "që të shfrytëzohen mundësitë e komisionit për raste të veçanta". Me sa duket integrimi i suksesshëm i familjes, Ajazaj ka bindur sena-



Georg Pazderski, (AfD), i njohur me rastin e familjes Ajazaj u shpreh pro qëndrimit të familjes shqiptare, shkruan gazeta gjermane "Bild", duke theksuar se AfD "do të mbështeste votën e komisionit për shqyrtimin e rasteve të veçanta"

torin për çështjet e brendshme të Berlinit, Andreas Geisel, sepse u vendos që dëbimi i familjes të pezullohet dhe të shqyrtohet edhe një herë rasti. Pasiguria se do të kthehet sërish aty e ka rënduar jetën e familjes në javët e fundit, por tani Xhezo Ajazaj dhe familja e tij mund të marrin frymë lirish dhe të shpësojnë. Të shpësojnë që autoritetet gjermane të vendosin për qëndrimin e tyre të përherëshëm në Gjermani.

(DW)

300 mijë euro për delegatët e Kushtetutës së Kaçanikut



Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur ka miratuar propozimvendimin për kompensimin financiar për delegatët e legjislaturës së vitit 1990. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica tha se do të ndahet një shumë prej 300 mijë euro për 111 delegatë. "Mjetet e financiare janë 300 mijë euro. Objektivi është që delegatëve të vitit 1990, pra 111 delegatë, ta gëzojnë këtë të drejtë. Shuma prej 300 mijë euro do të ndahet proporcionalisht për 111 delegat. Me aprovimin e këtij vendimi përbushet kompensimi financiar për del-

egatët e vitit 1990", tha ai. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj tha se me këtë po e përmbushin një obligim moral. "E kemi pasur obligim moral dhe po e përmbushim këtë të drejtë të mohuar gjatë", tha ai. Këta 111 delegatë më 1990 shpallën Deklaratën Kushtetuese (2 Korrik 1990) dhe Kushtetutën e Kaçanikut (7 Shtator 1990), akte që i paraprinë pavarësisë së Kosovës. Me këto ndërmarrje ata demonstuan patriotizmin, guximin dhe gatishmërinë për të sakrifikuar për të ardhmen e vendit dhe të popullit.



Arafati përkujtohet në përvjetorin e 13-të të vdekjes

Ish-presidenti i Palestinës, Jaser Arafat, është përkujtuar me aktivitete të ndryshme me rastin e 13-të vjetorit të vdekjes së tij. Një numër i madh i njerëzve nga vende të ndryshme të Ramallahut kanë marshuar drejt vendit ku gjendet mauzoleu i Arafatit, duke valëvitur flamuj të Palestinës dhe duke bartur posterë të Arafatit dhe presidentit aktual Mahmud Abbas. Duke folur në aktivitetin përkujtimor, zëvendës-kryetari i Lëvizjes Fatah, Mahmud el-Alul, e cilësoi Arafatin si "lider të dalluar"



dhe tha se ai është frymëzim për lëvizjet e lirisë në gjithë botën. Alul tha se do të vazhdojnë të ecin drejt qëllimit për të krijuar një

shtet palestinez të pavarur me kufijtë e vitit 1967, me kryeqytet Jerusalemin Lindor. Në ndërkohë, anëtari i Komitetit Qendror të Orga-

nizatës për Çlirim të Palestinës, Nasir Kudve, tha se përgjegjës për vdekjen e Arafatit është Izraeli. Edhe dy ditë më parë në një konferencë për media, Kudve ka theksuar se posedon prova të fuqishme, duke hedhur përgjegjësinë mbi Izraelin për vdekjen e Arafatit. Ndryshe, Jaser Arafat, ish-presidenti i Palestinës dhe lideri i Organizatës për Çlirim të Palestinës, ndërroi jetë në moshën 75 vjeçare më 11 nëntor të vitit 2004 në Spitalin Ushtarak "Percy" në kryeqytetin e Francës, Paris.

Skandali seksual, edhe Steven Seagal në listë

Një tjetër emër i njohur i shtohet listës së grabitqarëve seksualë, në skandalin që po trondit Hollivudin. Aktorja Portia de Rossi akuzon aktorin dhe producentin Steven Seagal për ngacmime seksuale. Bashkëshortja e prezantueses së famshme Ellen De Generes i ngriti pretendimet në një postim në rrjetin social Twitter. 44-vjeçarja pohon se gjatë një audicioni, Seagal i kishte thënë se sa e rëndësishme ishte kimia jashtë ekranit, duke zbrëthyer më pas zinxhirin e pantallonave. Menaxheri i aktorit të njohur të filmave aksion në vitet '80 e '90 deklaroi se ai nuk kishte komente lidhur me pretendimet. 65-vjeçari mori shtetësinë ruse nga presidenti rus në vitin 2016. Disa gra të tjera kanë akuzuar Seagal për sjellje të papërshtatshme dhe shantazh seksual përfshirë aktoren Julianna Margulies dhe Jenny



McCarthy. Ai është personi i fundit në Hollivud që përballet me akuzat të tilla, në vazhdim të skandalit që nisi me producentin Harvey Weinstein. Ne postimin e saj De Rossi deklaroi se në atë kohë i kishte treguar agjentit të saj por nuk u morr në konsideratë. Ajo nuk e specifikoi se për audicionet e cilit film bëhet fjalë apo vitin kur ka ndodhur incidenti. Aktorja austriako-amerikane është e martuar me De Generes prej 9 vitesh. Kjo e fundit shpërndau postimin e De Rossit për 75 milionë ndjekësit në Twitter, duke theksuar se ishte krenare për bashkëshortin.

Pavarësia i kushtoi shtrenjtë Katalonjës



"Kjo paqartësi politike tashmë reflekton në shifrat e papunësisë. Punësimi në Katalonjë për muajin tetor të këtij viti është ulur me mbi 10 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të një viti më parë", tha Rivadulla

Zëvendës-kryetari i Shoqatës së Biznesmenëve Katalonjas, Carlos Rivadulla, në lidhje me pavarësinë e Katalonjës tha se mbi 2.000 kompani kanë braktisur Katalonjën gjatë këtij procesi. "Këto kompani nuk kthehen. Të gjitha kompanitë që janë tërhequr nga Katalonja përbëjnë 30 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)", tha ai. Duke folur kundër pavarësisë së Katalonjës, Rivadulla në një deklaratë për gazetarin e Anadolu Agency (AA)

pas takimeve me përfaqësuesit e partive të ndryshme politike në Parlamentin Evropian (PE), ka bërë të ditur se kostoja ekonomike e ngjarjeve në Katalonjë ka nisur të reflektojë në shumë shifra. "Kjo paqartësi politike tashmë reflekton në shifrat e papunësisë. Punësimi në Katalonjë për muajin tetor të këtij viti është ulur me mbi 10 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të një viti më parë", tha Rivadulla. "Në Katalonjë, shifrat e konsumit kanë rënë. Kom-

panitë në sektorin e shitjes me pakicë operojnë me margjina shumë të ulëta fitimi. Kjo është një shifër e madhe për marketet dhe hotelet, edhe nëse shifrat vërehen se janë të ulëta. Këto shifra janë serioze", tha Rivadulla duke bërë të ditur se shitjet me pakicë në muajin shtator në Katalonjë janë rritur me 5.5 për qind ndër-sa muajin e kaluar kanë treguar ulje me 5.4 për qind.

Duke theksuar se në Spanjë, 10 për qind e të ardhurave kombëtare janë bazuar në turizëm, Rivadulla tha se "në këtë periudhë, sektori i turizmit i Katalonjës u ul me 30 për qind. Rezervimet e hoteleve gjithashtu ranë me rreth 25 për qind. Ky dëm është në të vërtetë për shkak të separa-

tistëve". Pasi ka tërhequr vëmendjen se situata ekonomike është bërë "shqetësuese" për biznesmenët, Rivadulla, tha se "Dy banka të mëdha dhe dy kompani të energjisë në Katalonjë janë transferuar. Gjysma e kompanive në sektorin e sigurimeve dhe farmaceutike janë larguar nga Katalonja. Mbi 2.000 kompani kanë braktisur Katalonjën gjatë kësaj periudhe. Këto kompani nuk kthehen. Të gjitha kompanitë e tërhequra nga Katalonja përbëjnë 30 për qind të PBB-së së rajonit". "Ka patur rënie serioze të investimeve të huaja pas përpjekjeve të pavarësisë në Katalonjë. Kjo situatë në muajt në vijim do të ndikojë shumë në shpërndarjen rajonale të të ardhurave dhe do të ndikojë në mbledhjen e taksave", thekson Rivadulla duke mbrojtur idenë e tij se humbjet e tilla ekonomike mund të përmirësohen me krijimin e një qeverie që respekton Kushtetutën spanjolle në zgjedhjet e 21 dhjetorit. "Çdo gjë është shumë e re dhe zhvillohet shpejtë. Shoqëria është shumë e ndarë. Disa biznese nuk duan ta shpjegojnë atë në mënyrë që të mos thyejnë guximin e të tjerëve pavarësisht nga rëniet shumë serioze të shitjeve", tha Rivadulla duke bërë të ditur se është shumë e vështirë të përcaktohet kostoja e përgjithshme e iniciativës për pavarësi.

Vatikani do të ndalojë shitjen e cigareve

Shitja e cigareve në market dhe dyqanin e mallrave pa taksa doganore në Vatikan do të ndalohet. Në një deklaratë nga Vatikani thuhet se me urdhrin e Papa Françeskut, punëtorëve u është ndaluar blerja e cigareve në market dhe dyqanin e mallrave pa taksa doganore. Vendimi është marrë me arsyetim se "Autoriteti i Papës nuk do të kontribuojë në një aktivitet, i cili haptazi dëmton shëndetin e njeriut". Në deklaratë po ashtu u theksuan të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) ku thuhet se cigarja çdo vit shkakton vdekjen e më shumë se 7 milionë personave në botë. Sipas lajmit të "Avarice", i publikuar në vitin 2015 dhe që bazohet në dokumentet e Vatikanit, shitja e cigareve në dyqanin e mallrave pa taksa doganore për një vit realizonte përfitime në vlerë prej 10 milionë eurosh në vit për Vatikanin.

Prova të reja kundër infermierit që vrau 100 pacientë

Prokurorët në Gjermani kanë deklaruar se kanë prova se një ish-infermier ka vrarë të paktën 100 persona në dy spitale ku kishte punuar. Hetuesit besojnë se Niels Hoegel, që aktualisht po shlyen një burgim të përjetshëm për dy vrasje, u ka administruar sistematikisht doza fatale të sëmurëve nën kujdesin e tij. Akuzat e reja,

të bazuara në analizat toksikologjike, pritet të ngrihen vitin e ardhshëm. Hoegel thuhet se ka vrarë 38 pacientë në Oldenburg dhe 62 të tjerë në Delmenhorst, dy lokalitete në veri të Gjermanisë, mes viteve 1999-2005. Sipas burimeve, ai donte të befasonte kolegët dhe pasi u administronte dozat fatale pacientëve përpiqej t'i sillte

sërisht në jetë, por shumica e tyre vdisnin. Prokurorët dyshojnë se Hoegel mund të ketë vrarë edhe më shumë, por një pjesë e trupave të atyre që mund të kenë qenë viktimat janë krentuar. Nëse shpallet fajtor për të gjitha vdekjet, ai do të rezultojë vrasësi serial më i keq që pas Luftës së Dytë Botërore. Hetimet ndaj

Hoegel u zgjeruan kur ai pranoi se kishte vrarë të paktën 30 persona, gjatë procesit gjyqësor të vitit 2015, kur u dënua për dy vrasje, dy tentativa vrasjeje dhe dëmtim të pacientëve. Hetuesit zharrosën 130 vetë për të kërkuar gjurmë të mjekimit që mund të kishte çuar në bllokimin e sistemit kardiovaskular të tyre.





Ajo lindi në vitin 1931 dhe numëron 258 role në teatër dhe mbi 90 të tillë në kinematografi. Karriera e saj shtrihet në gjashtëdhjetë vjet jetë skenike çka e bën atë një ndër aktoret më jetëgjatë të skenës shqiptare

Përse duhet të mudo-hemi aq shumë për të gjetur prejardhje të largët shqiptare për figura të njohura, kur kemi shqiptarë të vërtetë që njihen ndërkombtarisht? Kjo është një pyetje që ja bëj shpesh vetes kur, në bankat e auditorit të universitetit ku studioj, kam libra me shkrimtarë, piktorë e të tjerë lëvruar të artit për të cilët thuhet se janë shqiptarë, grek, kroat, rumun dhe italian. Me anë të kësaj politike rrëmuese, ne duket sikur artit shqiptar po i japim një tjetër fytyrë pak a shumë kopjace e cila nën vete fsheh gjithë ato figura të shquara dhe të rëndësishme që janë vërtetë shqiptare.

Një ndër këto figura, thuajse e harruar tani në pleqërinë e saj, është edhe "Artistja e Popullit" dhe "Nderi i Kombit" Tinka Kurti. Ajo lindi në vitin 1931 dhe numëron 258 role në teatër dhe mbi 90 të tillë në kinematografi. Karriera e saj shtrihet në gjashtëdhjetë vjet jetë skenike çka e bën atë një ndër aktoret më jetëgjatë të skenës shqiptare.

Ikona e artit skenik e kinematografik

Tinka në enciklopeditë e shteteve më të rëndësishme të botës



Karriera e saj fillon në vitin 1949 kur si aktore në teatrin "Migjeni" të Shkodrës shkëlqen si protagoniste me rolin e Files në dramën "Toka Jonë", dramë në të cilën do të interpretonte edhe pesëm-

bëdhjetë vjet më vonë, kësaj here në rolin e Lokes. Mes qindra roleve në drama të huaja dhe shqiptare, dua që të veçoj atë të Norës në dramën "Shtëpi Kukulle" të Ibsen-it, drama që shërbeu si

gjenezë e lëvizjeve femi-niste në Evropë.

E çuditshme është aftësia e Tinkës për të kaluar nga njëra gjini e dramës në një tjetër e pastaj në atë të filmit duke u përshtatur më së miri me rolet

që i jepeshin. Kështu nga roli shumë tragjik që kishte në dramën "Gjaku i Arbnit" ku duhet të vajtonte pesë djemt që i ishin vrarë në luftë, kaloi në rolin e Sonjës te "Histori Irkutase" e pastaj edhe në

atë të Desdemonës në "Otelon" e Shekspirit dhe Zonja Makbeth në "Makbethi" po të Shkkespirit.

Në kinematografinë shqiptare, vendi më i ndritshëm në plejadën e aktorëve i takon Tinka Kurtit e cila është aktorja kryesore e të parit film artistik shqiptar, "Tana" të shfaqur në vitin 1958. Pastaj vazhdon edhe me shumë role të tjera si ai i Nënë Pashakos në "Yjet e netëve të gjata" e deri te Halla në komedinë e famshme "Çifti i lumtur".

Sipas biografisë së saj bërë nga Marian Shestani, ajo ka fituar shumë çmime kombëtare të filmit mes të cilëve përfshihet edhe ai i karrierës. Emri i saj gjendet në enciklopedite ruse, indiane, egjiptiane, hungareze, britanike dhe amerikane, ndërkohë që teatri shqiptar në Malmoe mban emrin e saj. Tinka Kurti mbetet padyshim një ikonë e artit skenik e kinematografik shqiptar si një artiste e dimensioneve madhore të skenave tona.

Ekspozitë

Trashëgimia post-osmane e Ballkanit

Kjo ekspozitë udhëtuese eksploron se si Ankaraja, Stambolli, Beogradi dhe Sarajeva ndryshuan pas rënies së Perandorisë Osmane.

David GALIÇ

Qytetet janë organizma të gjalla dhe fluidë që nuk reshtin kurrë së u transformuar dhe transformimi drejtohet nga nevojat praktike të banorëve të tij si edhe nga rrethanat gjeopolitike dhe historike. Historikisht, Ballkani ka kaluar një sërë transformimesh që e ndryshuan rajonin në aspektin kulturor, politik dhe sociologjik. Një pjesë e madhe e Ballkanit u sundua për shekuj me radhë nga Perandoria Osmane dhe kjo la një shenjë të madhe në gjeografinë urbane të qyteteve të saj. Një ekspozitë e re që do të hapet së shpejti në Muzeun Historik të Serbisë shqyrton mënyrat në të cilat katër qytete në Turqi dhe në ish-Jugosllavi ndryshuan në fillim të viteve 1900 dhe se si ky ndryshim u gurmua dhe u dokumentua nga fotore-



porterët dhe gazetarët e hershëm. Qytetet në lëvizje - Trashëgimia post-otomane sjell 200 fotografi dixhitale të përpunuara të realizuara nga gazetarët turq dhe jugosllavë nga vitet 1920 dhe 1930 që punonin për gazetat kryesore rajonale si "Cumhuriyet", "Aksam", "Politika" dhe "Vreme".

Këta gazetarë u endën nëpër qytetet e tyre të lindjes - Ankara, Stamboll, Beograd dhe Sarajevë - në një mision për të dokumentuar se si


ndryshuan qendrat urbane për të pasqyruar kohët e reja, politikën e reja dhe tendencat e reja kulturore. Perandoria Osmane e kishte qendrën e saj administrative dhe politike në Turqi, por ndikimi i saj kulturor dhe politik ishte shumë i pranishëm dhe mjaft i fortë në të gjitha territoret nën sundimin e saj. Qytete kryesore të Ballkanit, pjesë të territorit që më vonë do të bëhej Jugosllavia, kishin tipare të forta të këtij dominimi. Kjo

ishte, dhe deri në një masë vazhdon të jetë ende, e dukshme në planifikimin urban dhe arkitekturë, por edhe në jetën e përditshme të njerëzve që jetojnë në ato qytete. Kur Perandoria Osmane ra, gjërat filluan të ndryshonin, ngadalë, por në mënyrë të qëndrueshme dhe, fatmirësisht, këta dhe shumë gazetarë të tjerë ishin atje për të dokumentuar ndryshimet. Nga njëra anë, qeveritë e reja që morën pushtetin nga

aparati i vjetër osman kishin një qëllim në mendje: t'i bënin qytetet të pasqyronin një njeri të ri, një qytetar të ri modern. Ata modernizuan qendrën urbane dhe prezantuan inovacione në të gjitha nivelet e jetës së përditshme. Nga ana tjetër, shumë aspekte të jetës së përditshme në këto qytete vazhduan të mbeteshin të pa shqetësuara, duke ndjekur të njëjtat modele kulturore dhe sociologjike që mund të shiheshin gjatë sundimit turk. Ky kontrast është i dukshëm në shumë nga fotografitë që do të shfaqen si pjesë e ekspozitës. Si një ekspozitë udhëtuese, "Qytete në lëvizje" ka një qëllim të rëndësishëm. Ajo synon të dekonstruktojë njëanshmëritë dhe paragjykimet kundër grupeve të mëdha të imigrantëve nga territoret e pas-osmane në klimën gjithnjë e më ksenofobike të ditëve të sotme.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm është homazhi ndaj trashëgimisë dhe rrugëve të përbashkëta historike, që vazhduan pavarësisht dallimeve të qenësishme midis njerëzve që mund t'i kenë përjetuar ato disi ndryshe. Ekspozita është

ndërtuar gjithashtu si një lloj gjëgjëzë. Ajo kërkon nga publiku të gjejë se në cilin nga katër qytetet është shkrepur një fotografi në veçanti. Ky ushtrim nënvizon qartë faktin se kulturat e këtyre katër qyteteve janë shumë më të ngjashme sesa njerëzit kuptojnë apo duan të pranojnë. Publiku do të ketë gjithashtu një mundësi të realizojë fotografi para fotografish të mëdha peizazhesh urbane dhe të provojë kostume autentike nga vitet 1920 dhe 1930. Kuratorja e Qytete në lëvizje - Trashëgimia post-otomane është Natasha Mijuskoviç, e cila jep mësim Studime të Lindjes së Mesme në Universitetin e Baselit. Ekspozita është rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar si pjesë e projektit të hulumtimit shkencor SIBA - Një Qasje Vizuale në Jetën e Përditshme në Qytetet Turke dhe Jugosllave në vitet 1920 dhe 1930, financuar nga Fondacioni Kombëtar Zvicëran për Shkencën. Ekspozita në Muzeun Historik të Serbisë do të jetë e hapur nga 7 nëntori deri më 28 janar, pas të cilës do të zhvendoset në Stamboll, Sarajevë, Graz dhe në fund në Kembrixh.



Maqedonia në "Filipi i dytë" pret Norvegjinë

Musliu: Ta mbyllim vitin me sukses



Shkup, 10 nëntor - Përfaqësuesja e Maqedonisë në futboll të premtën u ka dhënë fund përgatitjeve, ndërsa sonte me fillim në ora 18.30 në "Filipi i dytë" do të zhvillojë ndeshjen kontrolluese me përfaqësuesen e Norvegjisë. Në rrafshin taktik, trajneri Angelovski me bashkëpunëtorët e tij ka testuar disa opsione gjatë çdo seance stërvitore, në një kohë që për pozicione lojtarë të ndryshme shikohen lojtarë të ndryshëm. Si staf teknik ashtu edhe futbolistët duan që në këtë ndeshje të tregojnë lojën e

tyre më të mirë me të cilën do kishin shënuar fitore edhe pse janë të vetëdijshëm se do përballen me një kundërshtar që preferon një lojë me shumë kontakte dhe luftë në ajër. "E kemi analizuar kundërshtarin. Të gjithë e dimë se si luajnë shtetet skandinave. Afërsisht luajnë si anglezët. Jemi të përgatitur maksimalisht sepse gjithë kohës jena stërvitur për një lojë e cila kërkon shumë duele ajrore. Tërë vitin përfaqësuesja e Maqedonisë, ka pasur suksese me të gjitha grup moshat dhe shpre-

sojmë se do ta mbyllim në të njëjtën mënyrë", tha Visar Musliu, futbollist shqiptar i Maqedonisë. Derisa në anën tjetër sulmuesi Ivan Triçkovski thotë se i pret një ndeshje e cila peshën e njëjtë sikurse çdo ndeshje eliminatorë. "Secili nga ne duhet maksimalisht të jetë i përgatitur, pasi që na pret një ndeshje kontrolluese e cila ka peshën e njëjtë sikurse çdo ndeshje eliminatorë. Ne në çdo ndeshje futemi për të shënuar fitore dhe ja tani pas një kohe të gjatë në atë renditjen erdhëm deri

"E kemi analizuar kundërshtarin. Të gjithë e dimë se si luajnë shtetet skandinave. Afërsisht luajnë si anglezët. Jemi të përgatitur maksimalisht sepse gjithë kohës jena stërvitur për një lojë e cila kërkon shumë duele ajrore. Tërë vitin përfaqësuesja e Maqedonisë, ka pasur suksese me të gjitha grup moshat dhe shpresojmë se do ta mbyllim në të njëjtën mënyrë", tha Musliu

tek pozita të cilën e meritojmë. Singërisht e meritojmë atë pozitë. Norvegjia është një kundërshtar, kundër të cilit është vështirë të luash. Nuk do jetë ndeshje e lehtë. - deklaroi Triçkovski. Ndërkohë që para kësaj ndeshje duke nisur nga ora 16:30 deri në ora 18:00, FFM-ja dhe Sektori për parandalimin e dhunës pranë SPB Shkup, do të zhvillojë disa aktivitete të cilat janë në kuadër të fushatës për parandalimin e prishjes së rendit publik dhe sjelljes jo të hijshme në garat sportive.

Kosova e vendosur për fitore




Pak shikues kishin dalë për ta përcjellë stërvitjen e parë të përfaqësueses së Kosovës në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Por ata pak tifozë - rreth 20 - patën çfarë të shihnin, mbi të gjitha angazhimin e lojtarëve për çdo top. Presionin që e kishin në ndeshje eliminatorë me nuk e kanë dhe kjo vërehet tek gjithsecili prej tyre. Qysh në stërvitjen e parë ata u shprehën të bindur se do të dalin fitues nga miqësorja kundër Letonisë, që zhvillohet më 13 nëntor në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. "Luajtmë për herë të parë në eliminatorë, por mungesa e eksperiencës

bëri që ta mbyllim edicionin me vetëm 1 pikë, pavarësisht se në fushën e lojës dhamë shumë më tepër. Në këtë miqësore do të kërkojmë të fitojmë, pasi përveç lojës duhet të marrim edhe rezultate", deklaroi Rashica, talenti i Kosovës dhe i Vitezes në Holandë. Në fakt, fitoren thonë se e kanë obligim për zhgënjimin që ua kanë sjellë tifozëve gjatë eliminatorëve për Botërorin "Rusia 2018", ku u regjistruan nëntë humbje dhe një barazim. 15 prej 20 futbollistëve të ftuar do të luajnë për herë të parë në Kosovë. Kjo i bën ata edhe më të motivuar për të kërkuar fitoren, të parën pas një viti e gjysmë gati.

Basha humb miqësoren me Turqinë

Futbollisti Migjen Basha nuk mund të rifitohet dot për ndeshjen miqësore me Turqinë, e cila do të luhet më 13 nëntor. Pas disa seance stërvitore të zhvilluara me lojtarin veçmas skuadrës, me një program të veçantë, mesfushori i ekipit kombëtar është larguar sot nga rezidenca e përfaqësuesja kuqezi në Antalia. Ai do të vazhdojë të ndjekë fazën e rikuperimit pranë klubit të tij. Trajneri Panuçi, pas një konsultimi me stafin mjekësor të kuqezinjve, vendosi që lojtari të largohet për shkak se koha e rikuperimit është e gjatë dhe lojtari nuk mund të jetë gati për këtë miqësore.



Gjatë këtyre ditëve, Migjen Basha është stërvitur veçmas, por ka rezultuar se koha e rifitimit të tij zgjat jo pak. Ndërkaq, edhe për efekt kohe, trajneri Panuçi nuk do të thërrasë zëvendësues të ri, pas largimit të Bashës.

Konfirmohet miqësorja

Drita e Gjilanit sfidon Shkëndijën

Shkup, 10 nëntor - Skuadra e Shkëndijës sot (e shtunë) do të zhvillojë takim kontrollues me Dritën e Gjilanit. Dy skuadrat prenotuan testin ditë më parë, ndërsa dje dhanë dritë jeshile për zhvillimin e kësaj ndeshje dhanë nga FFM dhe UEFA. Takimi luhet të shtunën në orën 14:30 në Qendrën Sportive në Tetovë dhe vjen si rezultat i pauzës në Ligën e



parë futbollistike të Maqedonisë dhe Superligës së Kosovës për shkak të paraqitjeve të përfaqësueseve respektive, ajo e Maqedonisë kundër Norvegjisë dhe Kosovës me Letoninë. Ndërkohë kuqezinjtë vazhdojnë të punojnë sipas planit edhe gjatë pauzës në kampionat, duke drejtuar fokusin kah sfida e radhës me Sileksin.

Paguhet 300 euro, por 1 gol i kushton 2 mijë euro



Kukësi ishte një nga klubet më aktive në merkaton e verës, për shkak edhe të largimit të plot 5 lojtarëve titullarë, mes tyre emra të mëdhenj si, Pero Pejic e Izair Emini, të cilët së bashku mbajtën peshën më të madhe të ekipit, sa u përket golave. Mbas largimit të tyre, Kukësi afroi Rauf Alijev, ish-futbollist e Kombëtares së Azerbajxhanit dhe Elis Bakaj. Nëse për Alijev, presidenti i Kukësit ra dakord për një rrogë fikse për të, nuk ka qenë kështu për Bakaj. Në fakt, është Bakaj lideri i këtij Kukësi, jo vetëm për shkak të golave, por edhe të

lojës së tij. Zbulohet një fakt mjaft interesant të marrëdhënies kontraktuale të Bakaj me Kukësin. 30-vjeçari nuk e ka përfitimin e madh financiar të tij nga rroga e Kukësi. Ai ka një kontratë që përdoret shumë rrallë në kampionatin shqiptar. Bakaj paguhet në bazë të golave të shënuar, ku 1 gol i kushton 2 mijë euro. Ai ka një rrogë prej 300 eurosh në muaj dhe për çdo gol që shënon, përfiton dy mijë euro. Një gjetje mjaft interesante e palëve, ku Bakaj në këtë rast ka preferuar të tregojë veten se sa vlen dhe nuk paguhet artificialisht. Golat nuk

janë të rëndësishëm ku i shënon, në kampionat apo në kupë, mjafton që të realizohen në ndeshje zyrtare. Bakaj erdhi si një prurje shumë e rëndësishme të Kukësi, por jo me statusin e liderit ose të shpëtimtarit, por thjesht të një futbollisti të njohur. Besimi ndaj tij nuk ishte në shkallën sipërore, por ajo çka Bakaj pranoi të nënshkruante dhe ajo çka po tregon në fushë, është fantastike. Fantazisti ka shënuar deri tani 7 gola në 9 ndeshje në Superiore dhe ka marrë shpeshherë Kukësin për dore. Gjithashtu, futbollisti nëse kalon shifrën e

20 golave, do të përfitojë një bonus të majmë. Gjithashtu, nëse Kukësi fiton titullin ose Kupën e Shqipërisë, Bakaj do shpërblehet. Kujtojmë që edhe ish-sulmuesi italian, Kristian Vieri, kur ishte në fund të karrierës, në 2008-2009, vendosi të luante me Atalantën dhe pranoi një pagë modeste mujore prej 1.500 eurosh dhe bonus 1000 mijë euro për çdo gol. Atë sezon, sulmuesi shënoi dy gola. E njëjta gjë ndodhi te Partizani dy vite më parë me Xhevahir Sukaj. Sulmuesi, përveç pagës mujore, përfitonte edhe 2 mijë euro për çdo gol të shënuar.



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë
SHPALLJE

Kërkesë për ndryshimin e A – Lejes së integruar ekologjike për Minierën SASA DOOEL Makedonska Kamenica rr. Rudarska nr. 28, 2034 Makedonska Kamenica Republika e Maqedonisë

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr. 11-1656/2 nga 13.04. 2017 për ndryshimin e A - lejes së integruar ekologjike. Dorëzuesi i kërkesës: Miniera SASA DOOEL Makedonska Kamenica rr. Rudarska nr. 28, 2034 Makedonska Kamenica Republika e Maqedonisë

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit koordinativ nacional:
T-1 7626807 4663459
T-2 7626437 4663720
T-3 7625821 4664573
T-4 76251 7 4664627
T-5 7624820 4665460
T-6 7624526 4665291
T-7 7624058 4665567
T-8 7623888 4666020
T-9 7623602 4666461
T-10 7624027 4666706
T-11 7623836 4667490
T-12 7624200 4667700
T-13 7624339 4667778
T-14 7624786 4666967
T-15 7625131 4666857
T-16 76 5750 4665811
T-17 7625838 4665023
T-18 7626248 4664647
T-19 7626938 4663678

Personi për kontakt: Marija Stojanovska
Udhëheqës i njësisë për mbrojtjen e mjedisit jetësor

e-mail: m.stojanovska@sasa.com.mk
Instalacioni bien nën aktivitetet nga Shtojca I Pika 2.5 (a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para minerale me procese metalurgjike, kimike ose me procese elektrolitike.
5.6 Instalacione për menaxhimin e mbetjeve nga minierat

Lloji i aktivitetit:
Gërmimi dhe përpunimi i 770,000 - 780,000 ton mineral / vit
Kërkesa në formë të shtypur , do të jetë e ekspozuar , për shqyrtim për të interesuarit në afat prej 15 ditëve që nga dita e daljes së kësaj Shpallje në shtypin ditor, në lokalet e :Zyrës për komunikim me publikun pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor
Kej Dimitar Vllahov nr. 4 , kati 1 (objekti i vjetër i Bankës Komerciale), 1000 Shkup.
Çdo ditë pune nga ora 10 – 16:00 dhe
Në hapësirat e Komunës së Makedonska Kamenicës, çdo ditë pune,
Në të njëjtën kohë kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mk
Të interesuarit informata më të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në tel. 078426016 (e-mail s.vasilevski@moep.gov.mk)
Të interesuarit në afat prej 30 ditëve që nga data e shpalljes së kërkesës, kanë të drejtë të parashtrijnë vërejtjet dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, bulevardi „Goce Delçev“, nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10) ,1000 Shkup.

Tajson Fury u rikthehet polemikave Xhoshuan e mund edhe kaq i shëndoshë

“Unë të godas në fytyrë dhe të mund edhe kaq i shëndoshë sa jam. Edhe pse jam “një derr i shëndoshë”. Nuk kam nevojë të bëhem elegant si ty, për të të hedhur në tapet”, ka thënë ish-kampioni i botës Tajson Fury



Tajson Fury i është rikthyer sërish polemikave dhe debateve me Antoni Xhoshua, duke deklaruar se mund ta mposhtë kampionin e botës në peshat e rënda në çdo moment edhe pse është një “derr i shëndoshë”, shprehje e përdorur së fundi nga Xhoshua. Boksieri Fury, që ka pohuar pak ditë më parë se do të përballlet me Xhoshua verën e ardhshme, nuk ngjitet në ring prej dy vitesh, ku mundi Vladimir Klitçkon në nëntor të 2015-ës dhe mori titujt kampionë, që më pas i dorëzoi. 29-

vjeçari është ende në pritje të një vendimi që do të marrë antidopingu britanik, që pritet t'i japë licencën për boksing, e cila iu hoq pas skandalit doping (doli pozitiv me kokainë). Xhoshua u shpreh se Fury është i shëndoshë dhe e ka ftuar të rikthehet një formë për të dueluar sërish. “Ky është një mesazh për boksierin e peshave të rënda, të madhin Antoni Xhoshua. T'i më fton të kthehem në formë? Të jem i ndershem

me ty, nuk kam nevojë të jem në formë, për t'u bërë një njeri si ty. Unë të godas në fytyrë dhe të mund edhe kaq i shëndoshë sa jam. Edhe pse jam “një derr i shëndoshë”. Nuk kam nevojë të bëhem elegant si ty, për të të hedhur në tapet”, ka thënë ish-kampioni i botës Tajson Fury. Ende nuk dihet nëse ky duel mes dy boksierëve britanikë do të zhvillohet, teksa në skenë janë edhe Deontaj Vilder e Joseph Parker.

Publicitet

Në bazë të nenit 64 paragrafi 3 alineja 7 të Ligjit për arsim sipëror (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 35/08...), dhe Vendimit nga Dekani të Fakultetit për siguri nr. 04-859/1 të datës 08.11.2017, Dekani i Fakultetit për siguri – Shkup, njësisia në kuadër të Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir publikon

KONKURS

Për zgjedhje të:
Mësimdhënësit

- një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore E drejta administrative (50802);

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Statutin e Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit “Shën Kliment Ohridski” – Manastir dhe akteve të përgjithshme të Fakultetit.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shuma e të hollave e pagës bazë (në shumë bruto: 51.436,00 denarë/56.430,00 denarë/ 63.650,00 denarë) për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimdhënësi.

Fletëparaqitjet të dorëzohen në Arkivin e Fakultetit për siguri, rr. “1” Kolonia Idrizovë nr. 2A, Shkup, me shenjë “Për konkurs”.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë (në tri kopje), dokumente për arsim të mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe nga një kopje të punimeve të publikuara veças ose në publikim, dhe formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues (merret në fakultet).

Konkursi zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI PËR SIGURI – SHKUP

Universiteti “Sv. Kliment Ohridski” – Manastir

Fakulteti për siguri – Shkup

LAJMËRIM

Mbrojtje publike të disertacionit të doktoratës nga kandidati m-r Biljana Bogdanova Smilevska me titull:

“Efikasiteti i organeve të ndjekjes penale në parandalim, zbulim, qartësim dhe dëshmim të veprave penale që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e drogës”

do të mbahet më datë 20.11.2017 (e hënë) me fillim në ora 12:00, në Fakultetin e sigurisë – Shkup, rr. “1” Kolonia Idrizovë nr. 2A – Shkup në lokalet e bibliotekës.

NGA FAKULTETI PËR SIGURI
SHKUP

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08.....127/16); nenit 40 të Rregullores për marrëdhënie të brendshme dhe të punës së Fakultetit Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare nr. 287/2014), dhe nenit 34 paragrafi 1 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare 274/2013), Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 6.11.2017 ka sjell Vendim për publikimin e:

KONKURS

Për zgjedhje të një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor:

1. Të bëhet zgjedhje e një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sfera Sociologji për lëndët:
 - Sociologjia e arsimit, lëndë obligative për grupet studimore Mësim klasor dhe Edukim parashkollor, për mësimin në gjuhën maqedonase,
 - Sistemi religjioz, lëndë zgjedhore për grupet studimore Mësim klasor dhe Edukim parashkollor, për mësimin në gjuhën maqedonase dhe Sociologjia e kulturës, lëndë zgjedhore për grupin studimor Bibliotekist

Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim sipëror, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të parashtrijnë:

- fletëparaqitje;
- biografi të shkurtë;
- diplomë për arritje të shkallës shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet;
- formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues, që mund të merren në arkivin e Fakultetit
- Deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe
- certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve parashtrihen përmes postës në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune për kohën që do të zgjidhet.

Për Këshillin mësimor-shkencor të Fakultetit pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” Shkup
Dekan
Prof. d-r Emil Sulejmani



Barcelona është më shumë se një klub, është një kulturë

“Barcelona është me të vërtetë më shumë se një klub, është një kulturë; nuk di si ta shpjegoj atë. Ju duhet me të vërtetë të kuptoni ADN-në e Barcelonës për të luajtur atje”, – tha mesfushori në një intervistë me “Folha de Sao Paulo”



Paulinjo ndihet i lumtur dhe i plotësuar në Barcelonë. Mesfushori brazilian ka treguar në fillim të sezonit se ai është një futbollist që mund të bëjë dallimin në ndeshjet kyçe. Dhe Ernesto Valverde është shumë i vetëdijshëm për këtë. Përshatja e tij me klubin dhe qytetin po bëhet në rrugën më të shpejtë. E vërteta është se ish-lojtari i Korintians është i kënaqur që luan pranë yjeve të tillë, si Leo Messi, Suarez apo Andres Iniesta. “Barcelona është me të vërtetë më

shumë se një klub, është një kulturë; nuk di si ta shpjegoj atë. Ju duhet me të vërtetë të kuptoni ADN-në e Barcelonës për të luajtur atje”, – tha mesfushori në një intervistë me “Folha de Sao Paulo”. Në moshën 29-vjeçare, Paulinjo është në kulmin e karrierës së tij. Nënshkrimi për klubin katalanas nuk e ka zënë atë në befasi, pavarësisht se ka luajtur në

Guangzhou Evergrande, në Super Ligën kineze. “Unë kam ëndërruar gjithmonë për këtë moment, është diçka që me të vërtetë e dëshiroja dhe, fatmirësisht, ajo përfundoi duke ndodhur,” – shtoi braziliani. Për Paulinjon, të shkuarit te Guangzhou ishte vendimtare për të rifilluar karrierën e tij pas fazës jo shumë të frytshme të Tottenham dhe “KO” në

Kupën e Botës së Brazilit. “Scolari më kuptoi dhe më ndihmoi, i jam shumë mirënjohës për gjithçka bëri për mua në vitet e fundit,” – u shpreh ai. Paulinjo po përballet me një sezon shumë të veçantë në karrierën e tij: debutimin në Barcelonë, i cili do të përfundojë me Kupën e Botës në Rusi, ku Brazili është një nga favoritët për titullin.

Pas Andrea Pirlos edhe Çavi paralajmëron lamtumirën



Ky është viti fundit!

Vetëm pak ditë nga lamtumirë e Andrea Pirlos, një tjetër “regjizor” i madh i futbollit modern, Çavi Hernandez, lajmëron tërheqjen nga futbollit. 37-vjeçari, ish-kapiten e Barcelonës, që luan nga viti 2015 në Katar te Al Sadd, tregoi qëllimin e tij për të varur këpucët në gozhdë. “Kam pasur fatin të luaj gjatë dhe të mos pësoj dëmtime të rënda, por mendoj se parabola e karrierës sime është progresivisht në zbritje. E ndjej që po lodhem më shumë dhe e kam të vështirë të rikuperoj. Sigurisht që ky do të jetë

sezoni im i fundit si futbollist. Synoj që vitin e ardhshëm të pajisem me licencën e trajnerit dhe të nis një karrierë të re”, deklaroi Çavi. Çavi Hernandez është një nga futbollistët më virtuozë që ka njohur futbollit botëror. E ka nisur karrierën te Barcelona në vitin 1998 dhe për 17 vite më radhë ka veshur fanellën “blaugrana”. Me katalanasit ka zhvilluar në total 767 ndeshje, duke shënuar 85 gola. Ndër trofetë më të rëndësishëm që ka në “palmaresin” e tij janë 8 tituj të La Ligas dhe 4 Campions Liga



Dua të provojë një përvojë të re para pensionimit

Mesfushori i Barcelonës, Sergio Buskets, ka hapur derën për një lëvizje të tij në Ligën Premier te skuadra e Manchester Sittit. Buskets është lidhur me Sittin e Pep Guardiolas dhe pranon se Barcelona mund të mos jetë klubi i fundit i karrierës së tij. “Liga Premier është liga më e mirë si e tillë, mund ta shihni këtë”, ka thënë fillimisht reprezentuesi spanjoll. “Ndoshta unë mund të shkoj atje, por nuk ishte kështu, sepse jam në ekipin më të mirë në botë”, tha Buskets. Tutje, mesfushori spanjoll ka folur edhe për të ardhmen e tij, ku ka theksuar se nuk dëshiron të provojë edhe një përvojë të re para pensionimit. “Në nivel evropian apo të elitës, do të doja që Barça të ishte ekipi im i fundit, por do të doja të provoja një përvojë në një ligë tjetër, ndoshta në MLS (USA)”. “Guardiola ishte shumë i rëndësishëm në karrierën time, por për momentin unë jam mirë në Barcelonë dhe ai është në Manchester. Shpresoj të jem në gjendje të vazhdoj për katër vite të tjera dhe atë që nuk dua është që të jem në prapavijë. Unë nuk jam edhe aq i ri”, përfundoi Buskets.

Shumë më mirë pa Nejmarin

“Mundo Deportivo” dhe “Sport” publikojnë këtë të premte dy intervista me Zordi Alba, që kanë një titull befasues. Përkundër mbajtjes së një marrëdhënie të mirë me të (Alba ishte me Piken, një nga lojtarët që gjithmonë u shfaq në trajnim në të njëjtën kohë me atë), anëtori katalanas siguroi se me largimin e lojtarit aktual të PSZH-së, ai ka rënë dakord: “Nejmar është një lojtar i madh, i cili, për shkak të rrethanave, ose nd-



jenjave dhe mendimeve të tij, vendosi të largohet. Unë kam më shumë korsi për t'u ngjitur dhe singërisht, shumë më mirë për mua”, tha Alba. Ai gjithashtu, shfrytëzon

mundësinë për t'i dhënë Luis Enrikes një “spond”. Në këtë rast, pa kritika të drejtpërdrejta, por me vlerësimin e punës së Ernesto Valverde. “Unë jam i kënaqur me të, me të gjithë stafin. Komunikimi me lojtarin, si me ata që luajnë dhe jo, edhe më shumë me ata që nuk kanë aq shumë minuta, është e rëndësishme”, deklaroi Alba, i cili gjithashtu vlerësoi portierin Ter Shtegen dhe sulmuesin Luis Suarez.

“Cartier” dhe një vilë “dhuratë” Vakles



Një orë “Cartier”, që kushton nga 10 deri 20 mijë euro, e dhuruar në Doha në vitin 2015, dhe një vilë në Porto Kervo në Sardenjë. Këto janë “dhuratat” e presidentit aktual të PSZH, Nasser Al Khelaifi, për të korrptuar ish-sekretarin e përgjithshëm të FIFA-s, Zherome Vakle, të cituara, sipas “Le Parisien”, nga burime pranë Prokurorisë së Zvicrës. Të dy janë nën hetim në kuadër të blerjes së të drejtave televizive të Botërorit

nga “beIN Sports”, që drejtohet pikërisht nga sheiku nga Katar. Vakle akuzohet që ka përfituar padrejtësisht nga shitja e të drejtave televizive për Kupën e Botës që do të organizohet në vitet 2018, 2022, 2026 dhe 2030, ndërsa Al Khelaifit për ndikim të paligjshëm për të drejtat televizive të botërorëve të viteve 2026 dhe 2030. Vila “Bianca” në Porto Kervo, që ka një vlerë 7 milionë euro, tashmë është sekuestruar nga autoritetet.

Skuadra po plaket, ndryshoni strategji!

Një shqetësim i dhënë dhe i ripërsëritur. Robert Levandovski ka një dyshim: nuk është i sigurt nëse Bajerni do të mund të qëndrojë në nivelin e klubeve më të mëdha evropiane. Drejtuesit bavarezë, në fakt kanë këmbëngulur se nuk do të cmenden për të shpenzuar shifra jashtë logjikës së merkatos. Mirëpo nëpër Evropë, vetëm PSZH shpenzoi 400 milionë euro për Nejmar dhe Mbappe, ndërsa Barcelona 105 milionë, plus bonuset, për Dembele. Shuma më e madhe e shpenzuar nga Bajerni në merkaton e verës ishte 41.5 milionë për Tolisso. Leva nuk beson se kjo është strategjia e duhur. “40 milionë sot shpenzohen për futbollistë normalë, jo për më të mirët. Futbollistët e Bajernit po plaken, çdo skuadër ka nevojë për një lojtar të nivelit më të lartë çdo 2-3 vjet, për të rinovuar energjitë, përveçse për të sjellë më shumë cilësi. Klubet e tjera shpenzojnë



shumë vetëm për një futbollist. Nëse Bajerni dëshiron të ketë më të mirët në botë, duhet të jetë më kreativ dhe të ndryshojë strategji”, deklaroi sulmuesi polak. Bajerni, sipas “The Sun”, po punon për të gjetur zgjidhje, duke parë që nga Anglia janë të shumta skuadrat që kërkojnë sulmuesin polak. Mauro Ikardi konsiderohet si zëvendësuesi ideal i Levandovskit, por, për të arritur tek argentinasi, kampionët e Bundesligës duhet të shpenzojnë shumë më tepër se 40 milionë.



Të gjithë e dinë respektin që kam për Zidanin si lojtar, por gjithashtu si një trajner dhe ai ishte idhulli im. Nuk e di se çfarë do të ndodhë në karrierën time në të ardhmen, por sigurisht, do të ishte një ëndërr për mua të luaja nën drejtimin e Zidanit

Klubi i "Old Trafford" po punon me trajnerin e tretë që atëherë dhe ka fituar një Kupë të Anglisë, një Kupë të Ligës dhe një Liga Evropë, por titulli kampion në Angli ka qenë gjithmonë një utopi, pavarësisht se janë shpenzuar 700 milionë euro me blerjet e reja duke nisur nga vera e 2013-s, sipas dëshirave të David Mojs, Luis van Gal dhe trajnerit aktual Hoze Murinjo

Mançester Junajted e ka fituar titullin në Premier Ligë në vitin 2013-n, në momentin që trajneri i tyre legjendar, Sër Aleks Ferguson, u tërhoq pas çerek shekulli në drejtim të "djajve". Klubi i "Old Trafford" po punon me trajnerin e tretë që atëherë dhe ka fituar një Kupë të Anglisë, një Kupë të Ligës dhe një Liga Evropë, por titulli kampion në Angli ka qenë gjithmonë një utopi, pavarësisht se janë shpenzuar 700 milionë euro me blerjet e reja duke nisur nga vera e 2013-s, sipas dëshirave të David Mojs, Luis van Gal dhe trajnerit aktual Hoze Murinjo. Mediat angleze po vlerësojnë secilën prej blerjeve të Mançester Junajted, që nga vera e vitit 2013.

SEZONI 2013-14 - TRAJNER: DAVID MOJS - SHPENZIMI PËR SEZONIN: 73 MILIONË EURO

Marouane Fellaini - 31 milionë euro

Epoka post-Ferguson nuk nisi në mënyrën më të mirë të mundshme për "të përzgjedhurin" David Mojs, teksa dështoi në blerjen e Fabregas, Kedira, Herrera, Baines dhe Koentrao. Blerja e Fellaini nga Evertoni për 31 milionë euro u duk më shumë një akt dëshpërimi. Gjithsesi, ende sot e kësaj dite ai është i vlefshëm për Mançesterin. Nota: 7.5.

Huan Mata - 42 milionë euro

Me Mançesterin duke vuajtur në Premier Ligë, Mojs kishte nevojë për përforsime në janar 2014 dhe Mata u pa si zgjidhja e problemeve duke shpenzuar 42 milionë euro. Nuk u desh shumë kohë që Mata të bëhej i rëndësishëm duke u bërë titullar. Murinjo ishte trajneri që lejoi largimin e tij nga Çells dhe u mendua se ai do të largohej nga "Old Trafford" me ardhjen e portugezit, Mata ka qenë i rëndësishëm për Junajtedin, megjithatë ekziston përshtypja se ky do të jetë sezoni i tij i fundit në "Old Trafford". Nota: 8.

SEZONI 2014-15 - TRAJNER: LUIS VAN GAL - SHPENZIMI PËR SEZONIN: 170 MILIONË EURO

Ander Herrera - 36 milionë euro

Pasi dështoi me eksperimentin Mojs, Van Gal erdhi dhe nisi të shpenzojë për të krijuar një Junajted sipas imazhit që ai donte. Një vit më vonë, "djajtë" arritën të marrin Herraran nga Bilbao.

Kur 700 milionë euro nuk vlejnë sa Ferguson!



Spanjolli duhet të ishte "truri" i pasimeve në mes-fushë, por vetëm në fund të sezonit u bë titullar. Në sezonin e kaluar, Murinjo e nisi me të njëjtin dyshim ndaj spanjollit, por ai e mbylli vitin duke u shpallur "futbollistë më i mirë i sezonit". Nota: 8.

Luke Shav - 30 milionë euro

Kishte shumë entuziazëm rreth blerjes së Shav, që vinte nga dy sezone shumë të mira me Sautempton. Mendohej se ai do të luante për një kohë të gjatë si mbrojtës i majtë dhe e nisi mirë nën urdhrat e Luis Van Gal. Megjithatë dëmtime të vazhdueshme e penguan. Ai ka pasur edhe probleme të tjera fizike dhe aktualisht është jashtë planeve të Murinjës. Nota: 5.

Markos Roho - 20 milionë euro

Van Gal besonte se argentinasi Roho do të ishte një "shkëmb" në mbrojtjen e Junajted. Por disa dëmtime të vazhdueshme e penguan atë të ishte i rëndësishëm. Sezonin e kaluar e nisi me një marsh tjetër dhe arriti vendin e titullarit. Ai po shkëlqente derisa një dëmtim në çerekfinalen e Evropa Ligë e ka nxjerrë jashtë loje. Ashtu si Ibra, ai u dëmtua në prill dhe nuk do të kthehet para janarit 2018. Nota: 6.

Angel di Maria - 67 milionë euro

Mançesteri vuri një rekord me merkaton e kohës në Angli, kur mori Di Maria nga Reali me besimin se do të sillte cilësinë në garën për titull. Argentinasi nuk u përshat kurrë në "Old Trafford". Pa frikë, ai mund të konsiderohet si një nga blerjet më të dështuara në historinë e Junajtedit. U shit te PSZH për 50 mln euro. Nota: 3.

Dalej Blind - 17 milionë euro

Blind la përshtypje të mirë te Holanda që u rendit në vendin e tretë në KB. Në sezonin e tij të parë u paraqit në një nivel të kënaqshëm, pavarësisht se Van Gal nuk e ndihmoi aspak me ambientimin duke e aktivizuar në katër pozicione. Nën drejtimin e Murinjës e nisi si qendërmbrojtës, ndërsa tani është spostuar në të majtë. Ai konsiderohet si një element i vlefshëm për ekipin e Junajtedit. Nota: 7.

Viktor Valdes - gratis

Si disa herë fitues i Çampions Ligë, që ka luajtur më shumë se 500 ndeshje për Barcelonën, Valdes, i marrë falas, duhet të ishte krahu i djathtë i David de Gea. Junajted e la atë të rehabilitohej për një kohë të gjatë, por gjërat u thyen përfundimisht në momentin që spanjolli refuzoi urdhrin e Van Gaal për të luajtur me U-23. Ai u përjashtua nga skuadra duke mos lënë asnjë përshtypje në "Old Trafford". Nota: 2.

Radamel Falkao - i huazuar

Tifozët e prisnin me një kënaqësi të jashtëzakonshme huazimin e Falkaos në ditët e fundit të merkatos. Fakti që "djajtë" nuk e blenë, nuk mund të konsiderohet një blerje e dështuar si ajo e Di Maria. Ai shënoi vetëm katër gola në 29 ndeshje dhe nuk u përshtat kurrë në Angli. Tash ai luan te Monako. Nota: 3.

SEZONI 2015-16 - TRAJNER: LOUIS VAN GAAL - SHPENZIMI PËR SEZONIN: 145 MILIONË EURO

Memfis Depaj - 28 milionë euro

Pas dështimit të Di Maria, Van Gal bleu

holandezin Memfis Depaj. Por, ai u më shumë i famshëm për mënyrën si jetonte në luks dhe ndiqte modën, sesa për atë që bënte në fushën e lojës. Shkëlqeu në fillim, por më pas nuk ishte në nivelin e pritshmërive. Sapo mbërriti, Murinjo në janar 2016 e "degdisi" te Lioni. Nota: 3.

Matteo Darmian - 15 milionë euro

Ashtu si Luke Shav, Van Gal donte dikë që të mbulonte krahun e djathtë dhe Darmian, ishte zgjedhja e duhur. Ai luajti rregullisht gjatë sezonit të parë edhe pse u duk se aktivizohej më shumë prej emergjencës së dëmtimeve sesa prej paraqitjeve të mirë. Në sezonin e kaluar, nën drejtimin e Murinjës, mori minuta të mëdha si mbrojtës i majtë. Nuk është i rëndësishëm, por të paktën Junajted mund ta shesë në çdo moment. Nota: 6.

Bastian Shvainshtaiger - 9 milionë euro

Shvainshtaiger erdhi me synimin për të bërë të njëjtën gjë te Junajted si te Bajerni, por Van Gal nuk e realizoi dëshirën. Gjermani nuk u bë kurrë lider i mesfushës dhe dy dëmtime e penguan. Murinjo vuri veton për largimin e tij nga "Old Trafford". Ai tani luan në kampionatin amerikan MLS. Nota: 5.

Morgan Shneiderlin - 28 milionë euro

Francezi kishte luajtur dy kampionate shumë të mira me Sautempton, ndërsa luajti rregullisht për Junajtedin dhe faktikisht u përshtat mirë si mesfushor me tipare mbrojtëse.

Por, më pas e mbylli sezonin në stol dhe Murinjo i tha që nuk bënte pjesë në planet e tij duke

e shtyrë të rikthehej te Evertoni.

Sergio Romero - gratis

Pas Valdes, Van Gal pati fat me portierin tjetër të marrë gratis, argentinasi Romero. E nisi sezonin si titullar, duke parë gjendjen që po kalonte David de Gea, në momentin që dështoi transferimi i tij në Madrid. Romero u tregua në lartësinë e duhur dhe u vlerësua nga tifozët. Edhe Murinjo ka besim te ai, pasi Romero ishte titullar në të gjitha ndeshjet e Liga Evropë, ku "djajtë" ngritën trofeun. Nota: 7.

Antoni Martial - 70 milionë euro

"Adoleshenti" i ardhur nga Monako, Martial, ishte një bast i Van Gal. Në sezonin e tij të parë gjërat nuk shkuan keq dhe Martial shënoi 17. Gjithsesi, ardhja e Ibrahimoviç dhe shpërthimi i Rashford i pakësuan minutat atij.

Por sivjet gjërat kanë nisur ndryshe dhe faktikisht specialistët po binden se Martial është një nga lojtarët më cilësor në Premier Ligë. Nota: 7.

SEZONI 2016-17 - TRAJNER: JOSE MURINJO - SHPENZIMI PËR SEZONIN: 165 MILIONË EURO

Erik Bailly - 34 milionë euro

Murinjo pasi zëvendësoi Van Gal nxitoi të përforconte mbrojtjen me blerjen e Bailly. Edhe pse mungoi rreth dy muaj si pasojë e një dëmtimi në gjurin e majtë, Bailly ishte titullar i Mançesterit dhe ishte protagonist në arritjen në finalen e Evropa Ligë. Sot ai është zgjedhja numër 1 e Murinjës. Ai është një nga mbrojtësit më të mirë në Angli. Nota: 8.

Zlatan Ibrahimoviç, gratis

Ibrahimoviç mërti falas. Ai u konfirmua si një nga qendërsulmuesit më të mirë të planetit. Ishte futbollisti më i mirë i Junajtedit derisa u dëmtua. Ende nuk është ri-aftësuar, por mund të jetë i vlefshëm për pjesën e dytë të sezonit. Nota: 9.

Henrih Mikitarian, 31 milionë euro

Mançesteri e bleu në vitin 2016. Ka pasur momente kur kanë kuptuar që armeni është një gjeni i këtij sporti, si goli i shënuar kundër Sanderlend me thembër. Sivjet ai e nisi si titullar i padiskutueshëm, por sikur e ka ulur disi ritmin, pavarësisht se mbetet një nga futbollistët më cilësorë të Murinjës. Nota: 7.5.

Pol Pogba, 100 milionë euro

Mançesteri tregoi muskujt financiar duke vendosur rekordin e ri në merkaton e transferimeve me 100 mln euro. Pas një periudhe të vështirë në fillim, Pogba nisi të bëjë paraqitje me nivel.

Aktualisht është i dëmtuar, por askush nuk dyshon që do të rikthehet si titullar. Murinjo, ende nuk e ka humbur qoftë edhe për një moment të vetëm besimin te francezi. Nota: 7.

SEZONI 2017-18 - TRAJNER: JOSE MURINJO - SHPENZIMI PËR SEZONIN: 160 MILIONË EURO

Viktor Lindelof, 34 milionë euro

Edhe pse i stabilizuar në futbollin portugez dhe i aktivizuar në Çampions Ligë me Benfika, ka pasur disa kambana alarmi për paraqitjet e 23-vjeçarit. Murinjo nuk e ka aktivizuar në Premier Ligë dhe i ka dhënë disa minuta në Çampions Ligë. Kur bëri të kundërtën në ndeshjen kundër Hadersfield, Lindelof luajti jashtëzakonisht dobët bindur edhe më tej trajnerin se nuk e meriton fanellën e titullarit. Nota: 5.5.

Romelu Lukaku, 86 milionë euro

Junajtedi kishte nevojë të domosdoshme për një golashënues dhe zgjidhja ishte Lukaku. Ai nuk pati nevojë për shumë kohë që të tregonte përse kushtoi 85 milionë euro. Shënoi 10 gola në 9 ndeshjet e para me "djajtë", duke vendosur një rekord të ri në klub. Por, Lukaku nuk ka shënuar më që nga 30 shtatori. Nota: 8.5.

Nemanja Matić, 40 milionë euro

Matiç mori konsideratën e trajnerit portugez që bëri të pamundurën për ta marrë me vete në "Old Trafford". Ka luajtur në çdo minutë të Premier Ligë dhe Çampions në këtë sezon, sa për t'iu treguar besimin që Murinjo ka te ai. Nota: 8.5.

DASHI (20/III-20/IV)



Një ide e re do ju vije, pasi që jeni një person përplot ide dhe atë që në fillim të ditës çka që më vonë nuk do të shpenzoni shumë energji duke punuar. Në dashuri do të keni kohë të mjaftueshme për partnerin/ën.

DEMI (21/IV-20/V)



Mos u alarmoni shumë pasi që do të dëgjoni disa gjëra që nuk i keni dëshyuar më parë. Këto problemi do i zgjidhni me pak përkushtim! Ecnit me gjëra të cilat duhet t'i ndreqni sa më shpejt.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Merrni frymë thellë dhe kujtoni të gjithë të kaluarën gjatë ditës së sotme. Keni nevojë për t'i rregulluar disa gjëra. Lajmi i mirë është se vullneti i mirë do arrin që të përfundoni qëllimet e juaja me kohë!

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Keni nevoja konfliktuozë – kështu që duhet të zgjidhni sa më shpejt! Sidomos familja është duke ju vendosur në drejtime të ndryshme ashtu sikurse edhe shokët apo puna që ju bën të zhgënjeheni në ta.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Ju mund t'i shikoni gjërat në një mënyrë më ndryshe sot – por yjet ju sugjerojnë që të shkëmbeni ide më të tjerët! Do të shënoni më shumë pikë dhe do jeni më i fortë sesa shokët e juaj.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



Po kaloni kohë të vështira pasi që keni lënë punët pas dore! Megjithatë ia vlen pasi që kjo gjë do ju paguhet në të ardhmen! Tani për tani duhet që të vazhdoni me ritëm të njëjtë dhe mos të frustroheni tek të tjerët.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Duhet të zbuloni më shumë shokët dhe kolegët e juaj dhe gjërat që keni ëndërruar t'i bëni më seriozisht! Është një ditë e mirë për të bërë kërkesa të mëdha dhe t'i zgjidhni ato ashtu sikurse dëshironi!

AKREPI (22/X-21/XII)



Duhet të ngadalësoni paksa dhe të kujdeseni më shumë për gjërat e juaja personale. Një plan i juaj mund të vihet në rrezik. Është një mënyrë e mirë që të kërkonit këshilla nga shokët dhe familja e juaj.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Energjia e juaj e mirë do ju shtyjë për të bërë disa gjëra të çmendura ku do t'i tregoni botës se kush jeni ju! Keni shumë vetëbesim kështu që mund të arrini shumë gjëra nëse vazhdoni kështu!

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Nuk duhet të dorëzoheni para dëshirave të juaja. Këmbëngulja e juaj është një faktor çelës i suksesit tuaj dhe nëse vazhdoni të zbatoni planin tuaj do të realizoni atë para kohës së paraparë.

UJORI (20/I-19/II)



Ju dhe njerëzit e juaj kanë nevojë për punë por duhet punuar për të arritur disa vlera që nuk i keni. Ndoshta do ju duket e mërzi-tshme por në fund do keni sukses! Keni energji të mirë për të arritur suksesin që dashuronit.

PESHQIT (20/II-19/III)



Shefi i juaj dhe shoku nuk po pajtohen me disa ide të juaja! Andaj këtë problem duhet ta zgjidhni. Megjithatë mos i merrni shumë seriozisht kritikën e tyre pasi që nuk janë serioze.



Koha Koha Koha		KËNGËTARJA JONË NGA FOTO	...NË BOTËN E ÇUDIRAVE	POLICIA FEDERALE E SHBA	AMPER, ENERGJI	KËNGËTARJA JONË, BERISHA	TEKSTET E OPERAVE
TENISTI SPANJOLL, NADAL							
HARKU I NDRITSHËM ME NGJYRA NË QIELL							
SHTATË (ROMAK)				ZETA-BIT KËNGËTARJA, HALILI			
KAMPION				PERËNDI E VDEKJES NË MIT. HINDUSE FURNIZUES			
LOKAL KU PIHET KAFFE							
AUSTRIA				GODINAT MBI LUMË PREFIKS ME KUPITIM AJËR			
KUNDËR- SHTARI, KONKURRE- NTI		GARË AUTOMOBIL- LASH	PËRCËLLO- HEM NGA ZJARRI	ISH FUTBOLL FINLANDEZ, LITMANEN KALË SHALE		ELEKTRON PUNA NË ANALET	
JO I VJETËR			VRASJE POLITIKE VEND KU SUNDON EMIRI				
AI QË NUK HA MISH							DETYRAT E PËRKOQSHME ME PËRGJE- GJËSI
				PERËNDI VARR I NJË SHENJTORI MUSLIMAN		AMERCIMUM RADIO- TELEVISIONI I KOSOVËS	
LAPS					SHQIPONJA		
PUNIMI ME LIMË					FUSHË- BETEJAT		
ITALIA		VENDI PËRPARA OSE PRAPA SHTËPISË	NOTË MUZIKORE AKTORJA, SHARLIZ	NDËRROJ NJË BIMË BANORI I VENDEVE ARABE			
Koha Koha Koha	KOMPOZITORI ÇEK, SHIN					SHKRONJË E ALFABETIT GREK (14) GJYKIMI A PARIMI	
LIBËR FILLESTAR (shum.)	POETI YNË, SHKRELI					TORINO ZOTËRI (grek.)	
VËSHITRËSI			DEMONSTRATOR MODE NEGACION I YNI				
ERRËSOJ				QË PËRBAN BAZA (kim.) RREZE			
PJESËTARËT TË NJË PAKICE KOMBËTARE							

FJALËKRYO KLASIK

	1	2	3	4		5	6	7	8	
9					10					11
12							13			
			14			15		16		
17	18		19			20		21		
22		23		24			25			
26			27		28			29		
30				31						
	32					33				

HORIZONTALISHT:

1. Emër femre myslimane; 5. Organ komandimi; 9. Klub futboll turk; 12. Të ftohtat e dimrit; 13. Vegël muzikore popullore me dhjetë tela; 14. Ndihmës i ustait; 16. Ilaç; 17. Franko Nero; 19. Shuaj, fik; 21. Torino; 22. Mendim që na lind; 24. Shavar, kundje (bot.); 26. Këngëtarja jonë, Elsa; 28. Këngëtar i ynë, Redon; 30. Çinkurajohem; 32. Ymri; 33. Balerina, Gjoni.

VERTIKALISHT:

1. American Aviation Corporation; 2. Medikament; 3. Aktori egjiptian, Omar; 4. I eterit; 5. Sheron Stoun; 6. Gotë e metaltë; 7. Banor i vendeve arabe; 8. Themelet; 9. Maçok i famshëm nga stripat; 10. Shkretëtirë në Kil; 11. Poeti arbëresh, De Rada; 15. Metal i butë (Sn) (shq.); 18. Ndijoj; 20. Zatat, has; 23. Aktorja, Zomer; 25. Shaka; 27. Term sportiv; 29. Bëj shitje; 31. Radium.

Dëme të mëdha mund të na shkaktojnë valët e Wi-Fi-së

Dëmet shëndetësore që valët e Wireless-it mund të na shkaktojnë janë të shumta. Sipas studimeve të fundit në universitetin e Kalifornisë, ekspertët kanë nxjerr një konkluzion të përbashkët ku theksohet se ekspozimi ndaj sinjalit të Wi-Fi mund të shkaktojë dëme përkohshme në trupin e njeriut. Sipas raportit të publikuar, sinjali i Wi-Fi kontribuon në krijimin e dukurisë së pagjumësisë duke ju reduktuar aktivitetet e trurit me ç'rast ju



shkakton edhe ëndrra të pa qarta. Valët e Wi-Fi mund të ngadalësojnë

rritjen e qelizave në trupin e njeriut. Frekuencat e Wi-Fi-s çrregullojnë lë-

vizjet e spermatozoideve, gjë që pasqyron në dëmtimin e fatalitetit, kjo dukuri vlen edhe për femrat. Ekspozimi ndaj këtij sinjali rrit nivelet e stresit, tek porsalindurit dhe fëmijët sinjalet e Wi-Fi mund të dëmtojnë zhvillimin e fëmijërisë. Përveç sinjaleve të Wi-Fi, edhe sinjalet e 4G-s mund t'ju shkaktojnë dëme. Ekspertët sugjerojnë që të reduktoni përdorimin Wi-Fi kur nuk keni punë në internet dhe më e rëndësishmja, gjatë natës fikeni fare atë.

Ja çfarë u ndodhë atyre që shikojnë seriale në Korenë e Veriut

Arsyet për ekzekutime në Korenë e Veriut po bëhen gjithnjë e më të çuditshme e nga një pikëvështrim tjetër absurd. Kim Jong-un, nuk e falë askënd, madje as edhe për një gabim shumë të vogël. Ai i çon drejt pushkatimit të gjithë ata që nuk u binden urdhrave të tij, dhe bëjnë gabime, si p.sh të shikosh serial koreanojugore. Sipas shërbimit sekret koreanojugor, 50 oficerë e nëpunës zyrtarë janë ekzekutuar vetëm gjatë vitit 2014. Ndër ta edhe dhjetë ish-anëtarë të



Forcave të Armatosura, që u duhej të vdisnin, ndër të tjera, edhe sepse ata ishin kapur duke parë telenovela koreanojugore. Gazeta tjetër britanike, "Telegraph", pati raportuar se në Kore të Veriut shiten kopje të panumërta telenovelash e prodhime të tjera TV, në tregun e zi, të ardhura pikësepari nga Kina fqinje, por edhe nga armiku për vdekjeje i Phenianit zyrtar, Koreja e Jugut. Kim Jong-un e ka përshkruar ndjekjen e serialeve të telenovelave si një krim ndaj shtetit.

Vjen kamioni i parë elektrik



Tesla do të prezantojë kamionin elektrik më 16 nëntor konfirmoi kompania ditën e martë përmes një email-i dërguar për mediat. Kompania kishte planifikuar që kamioni të debutonte në fund të Tetorit sipas CEO-s Elon Musk por u shty për në Nëntor me arsyetimin e kompania kishte dedikuar resurset e saj prodhimit të baterive për Porto Rikon, vendin e prekur nga një uragan shkatërrues.

Ndërsa Tesla vuante burimet e duhura, Daimler prezantoi kamionin e parë elektrik dy javë më parë dhe ka një rang prej 350 kilometrash. Ndryshe nga gjysëm-kamioni i Tesla, ai i Daimler është për transporte të tonazheve të larta. Sipas raportimeve kamioni Tesla do të ketë një rang mes 320 km deri në 482 km, raporton CIO. Elon Musk tha se kishte bashkëpunuar me kompani të logjistikës për dizajnin e kamionit në mënyrë që tu përshtatet më mirë nevojave të tyre. Krahas të qenurit një kamion elektrik, Tesla mund të integrojë edhe disa sisteme autonome.

YouTube Kids, çdo fëmijë ka profilin e vet

YouTube përditëson Kids, aplikacionin e dalë në 2015 dhe dedikuar të vegjëlve. Kompania ka bërë të ditur disa ndryshime si në aspektin e jashtëm si në funksionet e kontrollit nga prindërit. Në Parental Control risia kryesore është mundësia për ata që kanë më shumë se një fëmijë, që çdonjëri prej tyre të ketë profilin e vet, krijuar në bazë të moshës, intereseve dhe zgjedhjeve të prindërve. Profili, siç shpjegon vetë YouTube në blogun e tij, nuk është i lidhur me një pajisje, por ndjek fëmijët në çdo tablet apo smartphone. Prindërit mund të vendosin edhe nga një fjalëkalim për çdo profil, i eliminueshëm në çdo moment. Ndryshimi më i dukshëm është dizajni, që varion në bazë të moshës së fëmijës. Për më të vegjlit do të ketë më pak tekst, ndërsa më të rriturit do të shohin një sërë përmbajtjesh ku mund të zgjedhin në faqen krye-



sore. YouTube Kids është i disponueshëm në 37 shtete, por ende jo në Shqipëri. Aplikacionin ka 11 milionë përdorues javor.

KALENDARË HISTORIK II NËNTOR

1158 - Perandori Frederik I Barbarossa shpall veten udhëheqës i Italisë Veriore.
1208 - Otto van Wittelsbach zgjidhet mbret i Gjermanisë.
1493 - Kolombo zbulon Sabën.
1500 - Traktati i Granadës: Franca dhe Aragoni ndajnë Napolin.
1606 - Turqia dhe Austria nënshkruajnë Traktatin e Zsitva-Torok
1752 - Akademia ushtarake Theresianische hapet në Vjenë.
1811 - Kartagjena në Kolumbi shpall pavarësinë nga Spanja.
1836 - Kili i shpall luftë Bolivisë dhe Perusë.
1918 - Polonia shpall pavarësinë.
1961 - Stalingradi riemërohet Volgograd.



1969 - Jim Morrison arrestohet në aeroportin nga FBI për deheje.
1975 - Angola fiton pavarësinë nga Portugalia.
2001 - Gazetarët Pierre Billaud, Johanne Sutton dhe Volker Handloik vriten në Afganistan

gjatë një sulmi të një konvoji në të cilin udhëtonin.

2004 - Yasser Arafat shpallet i vdekur nga Organizata për Lirinë e Palestinës nga shkaqe të panjohura.

A E DINI SE...



Çikago është vendi ku ndodhet parku zoologjik "Linkoln", një nga kopshtet zoologjike të pakta në botë ku mund të hysh falas.

Biblioteka Publike e Çikagos është krijuar nga hiri i zjarrit të madh të Çikagos në vitin 1873.



Jane Addams, banore e qytetit të Çikagos, ishte gruaja e parë amerikane që fitoi çmimin "Nobel" për paqen në vitin 1931.

BARSOLETA



TATUAZHET

Një grua ka si tatuazh mbi gjinjët fytyrat e dy dashnorëve të saj të parë. Natën e dasmës i shoqi e merr këtë fakt me filozofi.
- Po mendoj, pas ndonjë viti sa do t'u zgjatet turiri...

THËNIA E DITËS

Fitimtari gjen gjithmonë një mënyrë, humbësi gjen gjithmonë një justifikim. (Lao Tzu)

